

PASHKO R. CAMAJ

“Porosia e kullës”, një betejë për të vazhduar trashëgiminë e të parëve

Bisedoi Bujar Hudhri



SHËNIME MBI LIBRAT

Nga parathënia për librin “Porosia e kullës”
RRUGËTIMI SHPIRTËROR DHE
SOCIAL I PASHKO R. CAMAJT
NË LIBRIN E TIJ ME KUJTIME

Nga Besnik Mustafaj

Pashko R. Camaj e ka letrarizuar rrëfimin e tij veridik. Në vlerësimin tim ai ka bërë zgjedhjen e duhur për t'i dhënë rëndësi gjuhës, duke ndërtuar atë që quhet “stil”. Kjo është në dobi të lexuesit, i cili do të përfshihet në lexim me një kënaqësi të shtuar. (fq. 4)

“Shpresë e venitur”, libri i Delvina Kërlukut

SKENA E FRIKSHME E PËRDITSHMËRISË SONË

Nga Dr. Demush Bajrami

Shumë rrëfime shqetësuese për shumë ngjarje të vërteta. Historitë e fateve njerëzore që i sjell autorja e librit “Shpresë e venitur”, Delvina Kërluku, do të prekin thellë ndjenjat e të gjithë atyre që do t'u bie në duar ky libër. (fq. 8)

Antologjia “Lule e vjedhur” - 23 autorë të Minoritetit
Etnik Grek, botuar nga NERAIDA

KRIJIME QË SYNOJNË TE MIQËSIA DHE BUKURIA E BASHKËJETESËS

Nga Mirela Karanxha-Koça (fq. 9)

Primo Shllaku, Peshë e padurueshme e pafajësisë

PAFAJËSIA E FAJSHME

Nga Mërgim Bektashi (fq. 10)

Romani i Shllakut, aq sa është ndërtuar mbi provat apo dëshmitë e një shoqërie që kishte kaluar një etapë skëterre në emër të lirisë, tregon përvuajtjet politike që popullit ia katandisën mbi supë, për pasojë edhe vetë subjektit të romanit.

“Shtëpia ime rrotullon qiellin” e poetit
Dhimitër Pojanaku, botuar në Bukuresht

SHKËLQIMI I VEPRËS SË HAPUR

Nga Ardian Christian Kycyku (fq. 11)



Nga blloku i shënimeve për përkthyesen e njohur të autorëve shqiptarë në bullgarisht

Mirënjohje përkthyeses Marina Marinova

Nga Abdurrahim Myftiu

Me një mikun tim vendosëm t'i bëjmë një vizitë në shtëpi Marina Marinovës. Ai, për arsye pune, e kishte njohur prej kohësh, qysh në vitet '60, si mike të Shqipërisë dhe si përkthyesë të letërsisë shqipe në bullgarisht, dhe ishte takuar disa herë me të. Edhe unë e kisha njohur prej kohësh si përkthyesë, por tani do ta takoja sy më sy për herë të parë. (fq. 6)

Autorja koreano-jugore Han Kang fiton Çmimin Nobel në Letërsi për 2024

me motivacionin ‘prozë intensive poetike që ballafaqon traumat historike dhe ekspozon brishtësinë e jetës njerëzore’

HANKANG

“Nuk e kisha imagjinuar kurrë që Vegjetaria do të gjente kaq shumë lexues”

Përktheu Granit Zela

Fragment nga romani
“Vegjetaria”, botuar nga “Onufri”



BIBLIOTEKË

- Enver Kushi (fq. 13)
Xhaxhai im Jakup në Çamëri
- Resul Shabani (fq. 14)
Diçka po ndodh në skenë
- Roland Gjoza (fq. 16)
Melania
- Dituri Dizdari (fq. 15)
Njeriu me valixhe
- Xhelal Tosku (fq. 18)
Tani na ndan vetëm një vijë e hollë loti
- Arben Mexsi (fq. 19)
Karikatura e së shtunës
- Ruzhdi Gole (fq. 20)
Taksën e vetes e paguaj me brengë
- Mehmet Elezi (fq. 21)
Konferencë shkencore në lugjet e verdha

Kronika e një çmimi,
CAMAIORË 2024,
fitues Visar Zhiti
Përgatiti Eda Agaj Zh.

Idashur Pashko, para disa muajsh, poeti dhe shkrimtari i njohur Besnik Mustafaj më foli për një libër që kishit shkruar në anglisht, të cilin donit ta botonit edhe në shqip, pikërisht tek "Onufri". Tani që është në duart e lexuesit shqiptar, çfarë provoni?

Në librin tim, në kujtimet e mia, kaloj nëpër një histori, në të cilën çdo lexues i moshës sime, apo i rrugëtimit tim, mund ta gjejë veten. Është ky një rrëfim përmes të cilin sjell grimca nga e kaluara ime, duke trajtuar një temë aq të pranishme në të gjitha trojet shqiptare, mërgimin, si temë e përbotshme. Nëse lexuesi është vetë emigrant, ose nëse dikush nga të afërmit e tij ka emigruar, ai do të gjejë veten në historinë time, që mund të trajtohet edhe si universale. Ajo tregon sfidat e mundimet me të cilat përballet brezi i parë derisa përshtatet në një botë të re, duke u ballafaquar me faktin se zemra dhe mendimet gjithmonë u kthehen në pjesën e parë të jetës së tyre, në rastin tim, njëzet vitet e para të jetës sime. Këto vite përbëjnë thelbin e historisë sime, e ndërlidhur ajo me të kaluarën tonë në vendin tim të origjinës, pjesën e Malësisë së Madhe, e mbetur në Mal të Zi (ish-Jugosllavi). Në librin tim përpigjem t'i përgjigjem një pyetje të thjeshtë që i bëra vetes shumë herë që nga dita kur u largova nga vendi im në vitin 1985. Kjo pyetje e thjeshtë, por në esencë shumë e komplikuar, ishte: A mos kam mëkatuar kundër etërve të mi duke u larguar nga vendlindja ime, duke lënë gjithçka që dija dhe gjithçka që baballarët e mi jetuan për shekuj me radhë? Duke iu përgjigjur pyetjes sime, mundohem të lë një mesazh të fortë për ata që do të vijin pas, këtu në vendin tonë të ri, se ata, ndërsa bëhen amerikanë, mund të ruajnë rrënjët e veta dhe të dinë se nga vijnë, dhe përmes kësaj të ruajnë trashëgiminë tonë shumëshekullore.

Ishit njëzet vjeç kur morët vendimin për të shkuar në Amerikë. Pas dyzet vjetësh morët vendimin për botimin e këtij libri. Ku e shihni njëfarë ngjashmërie?

Derisa rritemi dhe i afrohem pleqërisë, bëhemi më të mençur. Unë kam shkuar në SHBA si një 20-vjeçar pa e pasur të qartë se çfarë doja. Shpejt pas arritjes në SHBA e kuptova se ky ishte vendi ku do të realizoja ëndrrat e mia. Meqë m'u dha kjo mundësi, kam edhe një histori për të treguar, një histori që nuk është glorifikim i arritjeve dhe i të jetuarit të ëndrrës amerikane, edhe pse është pjesë e saj, por më e rëndësishmja për t'u dhënë jetë atyre që ishin heronjtë e botës sime dhe që më kanë frymëzuar të bëhem ai që jam sot. Është një histori që kapërcen kohën, që mund të impresionojë në një nivel të vogël tek ata breza që vijnë pas nesh, që të mos harrojnë kurrë dhe të mund të shikojnë gjithmonë me admirim dhe dashuri atë pjesë të botës prej nga vijnë.

Sami Frashëri shkruan diku: "...

PASHKO R. CAMAJ

Porosia e kullës, një beteje për të vazhduar trashëgiminë e të parëve

Bisedoi: Bujar Hudhri

sado gjatë të jetojë njeriu, njëzet vitet e para të jetës së tij janë vitet më të gjata." Pikërisht këtyre viteve edhe ju u kushtoni pjesën më të madhe të librit. Pse kjo zgjedhje?

Sami Frashëri është një nga rilindësit e mi të preferuar, që i takon epokës që është baza e kombit, historisë dhe kulturës sonë. Edhe pse nuk e kam lexuar, kjo tingëllon kaq e vërtetë, sepse ato njëzet vite të jetës sime kanë dëshmuar të jenë më të rëndësishmet në formimin tim, për t'u bërë ai që u bëra më vonë. Koha me babain tim, edhe pse ajo ishte vetëm disa muaj, ishte ekspulsive vetëm për mua, sepse disa muaj më pas ai kaloi në amshim. Ishte një dritare në jetën e tij, e paraardhësve të tij dhe më e rëndësishmja, kjo kohë më ushqeu me ndjenjën e përgjegjësisë, dashurisë për

rrënjët tona dhe mirëkuptim edhe ndaj atyre që shpesh edhe në lëndojnë.

Jam kureshtar ta di, ndërsa lundronit në breg të liqenit të Shkodrës si adoleshentë, çfarë ishte për ju Shqipëria? A kishit qenë ndonjëherë?

Si një fëmijë i vogël, gjithmonë pyesja veten se çfarë fshihej pas pyjeve të errëta që rrethonin liqenin e Shkodrës, që ishte vetëm 2-3 kilometra larg nga fshati ynë. Kur hyja në ujëra të liqenit, pamja do të hapej aty ku mund të shihnim në të vërtetë një cep të Shqipërisë. Ishte gjithmonë tërheqëse, edhe pse në imagjinatën time asokohe, në Jugosllavi, Shqipëria shihej si një shtet i huaj dhe si armike, por ne e dinim më mirë se kaq, e dinim se ata janë vëllezërit tanë dhe se jemi një komb. Si një fëmijë, më kujtohet



Familja ime (pa Nikollën). Askush nuk e dinte se ku ndodhej – ndoshta po bënte ndonjë prapësi ose ka bërë këtë foton. Nga e majta në të djathtë, rreshti sipër: Shtjefni, Lezja, nëna dhe babai, Hana. Nga e majta në të djathtë, rreshti poshtë: unë, Frani dhe Drita.



se pranë shkollës sonë ishte rruga që çonte nga kalimin kufitar, ku ecnin dhjetëra nga kamionët shqiptarë me mbishkrim "ALBANIA" dhe ne si fëmijë do të rreshtoheshim pranë rrugës dhe i përshëndetnim sa herë që na jepej rasti. Ata përfaqësonin diçka që ne e kishim të ndaluar, diçka që e mbanim për vete dhe në shumë raste nuk mund ta shprehnim, por, ngaqë nuk guxonim gjë tjetër, as ne, e as ata, së paku i shikonim dhe i përshëndetnim me duart tona të vogla, me admirim. Shpeshherë, në bisedat me gazetarë nga Shqipëria, më bëhet pyetja se përse shqiptarët jashtë Shqipërisë, si edhe ne nga Mali i Zi, në dukje e duan Shqipërinë më shumë se ata që janë rritur në Shqipëri. Nuk jam i sigurt nëse kjo është e vërtetë apo jo, por e di që për ne që jetonim jashtë shtetit shqiptar, Shqipëria paraqiste token e ndaluar, edhe për shkak se ne nuk kishim shtetin tonë.

Keni mbaruar shkollën e mesme mjekësore në Podgoricë. Çfarë nuk ju hiqet ende nga mendja ndërsa kujtoni ato vite?

E vërtetë, unë kam ndjekur shkollën e mesme të mjekësisë në Podgoricë. Për mua kjo ishte një kohë impresionuese në fund të adoleshencës sime, ku çdo gjë ishte në frymën idealiste dhe çdo gjë u pa nga një perspektivë se ne jemi në një vend ku mundim të realizonim ëndrrat tona. Por, pikërisht aty në Podgoricë fillova të kuptoja se për ta isha një nga ata njerëz të cilëve nuk mund t'u besohet, malësorë e shqiptarë. Sjellja e njerit prej profesorëve të mi në shkollën e mesme të mjekësisë dhe trajtimi i padrejtë ndaj meje, më bëri që herë pas here do t'i thosha vetes se sa do të doja ta shihja edhe një herë, thjesht për t'i thënë se ishte aq i padrejtë, por, pavarësisht nga padrejtësia dhe sjellja e tij, ia dola, duke e konfirmuar se unë jam edhe më i mirë sa ai.

Si një nga disfatat e para në jetën tuaj ju veçoni rastin kur nuk fituat konkursin për t'u regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. E keni menduar ndonjëherë, nëse do të kishit mbaruar këto studime, si do të kishte rrjedhur jeta juaj?

Dëshira ime ishte të bëhesha mjek. Ajo ishte ëndrra ime edhe në fëmijërinë time të hershme. Unë punova për këtë dhe, në fakt, kalova nga shkollimi në gjuhën time shqipe në serbokroatisht,

vetëm që të regjistrohesha në shkollën e mjekësisë, ku dhe arrita sukses dhe mendova se isha gati të shkoja në nivelin tjetër, që ishte Universiteti i Mjekësisë në Prishtinë. Fatkeqësisht, në ato ditë, siç e theksoj në kujtimet e mia, kuotat e pranimit në këtë fakultet ishte shumë të pakta, pasi shumë njerëz e shihnin shkollën e mjekësisë si një ëndërr prestigjioze. Megjithatë, mendoja se ngaqë ishim vetëm dy shqiptarë që kishim aplikuar nga Mali i Zi, ndoshta duhet të kishim pak favorizim. Por ajo nuk ndodhi dhe nuk më pranuan në Fakultetin e Mjekësisë. Ishte, pra, një ndër disfatat e para në jetën time, që filloi të më bindë të largohesha nga vendlindja ime. Jeta mund të ketë qenë ndryshe për mua aty, por në një mënyrë që nuk do të kisha qenë në gjendje ta shihja jetën nga kjo perspektivë. Sinqerisht, jam i bindur se ajo ishte e vetmja mënyrë që mund të kisha parë me të vërtetë atë që nuk mund të shihja atëherë, një vend ku gjërat, edhe pse ishin të dukshme, nuk i shihnim.

Ndërsa mbaron së lexuari librin, ajo që të prek thellë është dashuria juaj për vendlindjen. Gati sikur ndiheni fajtor që e keni lënë, madje sikur ende jeni në dilemë. Mos ka ndikuar kjo ndjenjë juaja e brendshme që t'i vini edhe titullin versionit shqip "Porosia e kullës"?

Ndjenja e fajit apo, si e quaj unë, mëkatit, për largimin nga vendlindja ime është e dukshme dhe jo aq për veten time, por se si do t'ua shpjegoja se kisha lënë atdheun paraardhësve të mi, kullës sime, ku brezat e mi jetonin duke u munduar dhe vdiqën duke u përpjekur që të ruanin ekzistencën e tyre, në një vend dhe rajon që nuk ishte shumë mikpritës për ta. Në fakt, ishte shumë i dëmshëm për ta, megjithatë, duruan. Për mua nuk është çështja nëse pendohej ose kam dilemë që u largova nga vendi im, është më tepër një betejë për të vazhduar trashëgiminë e tyre, ndërsa kam arritur gjëra që ndoshta mund të kenë qenë të paarrishme për shumë të tjerë. Unë e përdor këtë si një ushqim për mua dhe në çdo gjë që kam bërë në jetën time dhe vazhdoj të bëj përpjekje të motivohem me: "A thua do t'i kishte pëlqyer kjo babait tim?"

Ju e keni shkruar librin në anglisht dhe po mendoja se çfarë ju ka shtyrë. Dyzet vjet jetë në Amerikë, sigurisht, kanë ndikuar që të jeni më i sigurt në atë gjuhë. Një favor jo i vogël ky për tregun e madh amerikan të librit? Apo gjenerata e shqiptaro-amerikanëve e kanë më të lehtë ta lexojnë në anglisht?

Kur fillova të shkruaja, nuk e dija me të vërtetë se në çfarë gjuhe do të shkruaja, por ideja ishte të lë një gjurmë për ata që do të vijnë pas. Më duhet të jem i sinqertë, shqipja nuk është një gjuhë e lehtë, megjithëse e flas shumë mirë dhe e lexoj jashtëzakonisht mirë. Unë këtu jam rritur e shkolluar, në anglisht, dhe kam vështirësi në gjetjen



e fjalëve dhe shprehjeve të duhura për shumë nga gjërat që shkruaj. Dua të them kështu që kjo është një arsye e madhe. Por tjetra arsye imja është se shpresoj që ky libër t'u arrijë amerikanëve, në veçanti për shqiptarët amerikanë, të cilët do ta kenë shumë më të lehtë ta lexojnë dhe ta kuptojnë në anglisht, pasi e gjithë kjo është e destinuar për ta në mënyrë që ata të dinë se kush janë e nga vijnë, kështu që të mësojnë dhe të kuptojnë disa nga gjërat që janë të epokës së shkuar, atje nga kohët që duhen mbajtur mend. Gjërat për të cilat flas në librin tim nuk janë leksione në histori a filozofi. Ato janë akte të thjeshta jete që ndoshta ia vlejnjë të mos harrohen.

Në shqip e ka sjellë vëllai juaj më i madh, Nikolla, i cili është aktualisht nënkryetar i Parlamentit të Malit të Zi. A mund të na thoni diçka për këtë përvojë të pazakontë mes dy vëllezërve Camaj? Nikolla nuk ishte thjesht përkthyes për ju në këtë libër, apo jo?

Duke u rritur, për mua, Nikolla ishte idhulli im. Ajo që më tërhiqte, ishte se ai gjithmonë ishte kureshtar të dinte se çfarë ka "përtej" apo çfarë ka në anën tjetër. Përveç asaj, më intrigonte se në njëfarë mënyre ai ishte "trim" dhe nuk

kishte frikë të eksperimentonte. Me kalimin e kohës, direkt apo tërthorazi, gjithmonë kam konkurruar me të për t'u siguruar që edhe unë të jem si ai, që edhe notat e mia në shkollë të ishin aq të mira sa të tijat. Jeta jonë mori kahe të ndryshme, megjithatë në ende mbetemi në atë marrëdhënie të ngushtë dhe ajo konkurrencë edhe sot vazhdon. Bile, shpeshherë kur ai bën një intervistë në TV apo diçka të tillë, i them "mjaft mirë e ke mësuar", sikur unë ta mësoja se si duhet bërë ajo. Ai nuk ishte thjesht përkthyesi. Unë i dhashë një version në anglisht, por pastaj ai e mori dhe e ripunoi, faktikisht e shqipëroi. Gjatë procesit të përkthimit të librit, ai shpesh do të më thërriste, pasi për shumë ngjarje që tregohen në librin tim ai ishte pjesë e tyre dhe i kishte parë ato, ndoshta nga një kënd tjetër apo pikëpamje të ndryshme. Kështu që, ndërsa po punonim me përkthimin, ai do të thoshte: "Oh, po, e mbaj mend edhe unë në këtë mënyrë", por edhe: "Më ke bërë të qaj, si mund t'i mbaje mend këto detaje", për ngjarje në të cilat shpeshherë edhe ai vetë ishte protagonist.

Duke lexuar librin, pothuaj ndihet modestia juaj për të mos folur për sukseset që keni pasur dhe keni në

fushën shkencore. Për respektin, pse jo, për gëzimin e lexuesit tuaj, a mund të na flisni për këtë përvojë në Columbia University apo të tjera universitete, për studimet që i ndoqët në një moshë jo fort të re?

Një nga gjërat që më tërhiqte gjithmonë te babai ishte modestia e tij. E shihja atëherë dhe e shoh tani se modestia është një virtyt, edhe pse ndoshta ndonjëherë duhet të kërkojmë falje dhe të dalim nga ajo. Në librin tim u përpoqa ta tregoj historinë time në një mënyrë që do ta vlerësoja atë, pa ndier ndjenjën e mburrjes sime për këtë, sepse kjo është gjëja e fundit që do të doja të bëja. Ditën e parë të kolegjit, në semestrin tim të parë, isha gati 29 vjeç. Nuk i thashë askujt se isha regjistruar, sepse kisha frikë nga dështimi. Arritjet e mia nuk ishin të zakonshme, si të një studenti këtu në SHBA apo gjetiu. Mora një rrugë të pazakontë dhe qarkore për të arritur suksesin, në kohën kur isha prind i tre fëmijëve dhe nuk i përballoja të gjitha me lehtësi, pasi isha ai që kujdesej për mirëqenien e familjes sime. I kam filluar ditët e arsimimit në një kolegji të qytetit të Nju-Jorkut, fillimisht një bachelor dhe pastaj master. Më vonë kam fituar një pozicion pune në një agjenci të shtetit të Nju-Jorkut, ku aktualisht jam ende i punësuar. Gjatë viteve kam mësuar se kisha nevojë të shtyja fort përpara për të pasur sukses. SHBA-ja është një vend mundësish, por duhet ta duash. Më në fund, arrita të marr diplomën, doktor i shkencave të shëndetit publik në Universitetin e Kolumbias në Nju-Jork. I afërt me mjekësinë, si epidemiolog, punoj në fushën e të kuptuarit dhe parandalimit të sëmundjeve. Një nga atributet e diplomës sime ishte se gjatë pandemisë COVID-19 isha shumë i përfshirë jo vetëm në punën time, por edhe duke qenë zë për shumë shqiptarë këtu në SHBA, gjithashtu edhe në atdhe. Gjatë dy viteve shumë intensive dhe të frikshme të pandemisë, u përpoqa të jepja sa më shumë informacion të mundshëm, që ishte i dobishëm. Pra, duke treguar se, edhe pse jemi në një pozitë të pasigurt, duhet të jemi gjithnjë optimistë, duke qëndruar të kujdesshëm për të ruajtur shëndetin tonë dhe gjërat do të përmirësoheshin. Duhet të kem bërë shumë intervista televizive, që ishin në orën 2 të mëngjesit në Nju-Jork, për shfaqjet herët në mëngjes në Shqipëri dhe Kosovë.

Prej vitesh jeni në një post shumë të rëndësishëm në Bashkinë e Nju-Jorkut. A mund të na flisni konkretisht, cila është përditshmëria juaj atje?

Pozicioni im sot është në një agjenci shtetërore të Nju-Jorkut për transportin publik me 60.000 punonjës dhe në shërbim të miliona njerëzve që çdo ditë përdorin sistemin tonë. Në pozitën e zëvendës-presidentit të departamentit që merret me shëndetin dhe sigurinë e fuqisë sonë punëtoresh, kryesisht



Një ditë me babain tim te pijaca duke shitur perime, korrik, 1979.

Ky libër i Pashko R. Camajt ka dy tituj. I shkruar fillimisht në anglisht, ai është botuar me titullin *Dreaming from the Trunk of an American Car* (Ëndërrime nga bagazhi i një veture amerikane). I përkthyer më pas në shqip nga vëllai i tij e njëherësh miku im, nënkryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Nikollë Camaj, libri po vjen në gjuhën amtare të autorit me titullin *Porosia e kullës*. Ky titull i dyfishtë përmban në të vërtetë dy kode të ndryshme për leximin pa keqkuptime të të njëjtit tekst, në përputhje me kontekstin historik e kulturor në të cilin është brumosur lexuesi anglishtfolës apo lexuesi shqipfolës. Por, do saktësuar se kjo qasje e dyfishtë ndaj të njëjtit tekst nuk shpreh ndonjë hermetikë të posaçme nga ana e autorit dhe as ndonjë qëllim të tij për t'i treguar lexuesit amerikan një fytyrë tjetër nga ajo që do t'i tregojë lexuesit shqiptar.

Një sqarim i tillë bëhet i nevojshëm nisur nga fakti se libri në fjalë është autobiografik. Pra, Pashko R. Camaj na ka treguar jetën e tij nga fillimi e deri aty ku është sot, një doktor në shkencat mjekësore dhe funksionar i rëndësishëm në shtetin e Nju-Jorkut. Po ta përfytyrojmë grafikisht rrugën e përshkuar, del një udhëtim shumë i gjatë dhe me shumë ulje-ngritje, ani pse autori-protagonist është ende i ri.

Do sjellë në vëmendje, gjithashtu, një problem moral që ka pasur Pashko R. Camaj e që duhej zgjidhur qysh para se të merrte penën. Është fjala për qëndrimin që do të merrte ai si autor ndaj vetes si protagonist i një teksti të paracaktuar për t'u botuar. Domethënë, për t'iu dorëzuar publikut.

Më së shpeshti, kjo lloj letërsie vuan nga një prirje e autorit për ta paraqitur veten si një viktimë e madhe e rrethanave të vështira jetësore dhe e njerëzve të pashpirt, me të cilët është kryqëzuar rruga e tij. Ose prirja tjetër për ta mburrur veten si një sfidant i paepur, me një fjalë hero, i cili, me vullnet dhe mençuri të jashtëzakonshme, i rrëzon një nga një pengesat me të cilat ndeshet në çdo hap dhe triumfon. Fjala këtu nuk është për personalitete të njohura nga opinioni publik, të cilat, në një çast të caktuar të rrugëtimit të tyre, vendosin të shkruajnë autobiografinë, për ta bërë të njohur të vërtetën, sipas tyre. Fjala është për njerëz të zakonshëm, krejt të panjohur nga opinioni publik, të cilët kanë papritur shtysën për të shkruar autobiografinë, për të kënaqur kështu, me vetëdije apo pa vetëdije, egon e vet. Shumë-shumë, familjarët dhe miqtë e një autori të tillë njohin nëpërmjet këtyre shkrimeve pasqyrimin që ai ka për veten e tij.

Një njeri i zakonshëm përkitazi me njohjen publike është edhe Pashko R. Camaj. Por ai e ka zgjidhur paraprakisht pa komplekse atë problemin moral, të përmendur më sipër. Edhe ai, natyrshëm, do të shtyhej nga egoja e vet për të shkruar një libër autobiografik. Ama, ai nuk do të synonte të ngjallte përreth keqardhje si viktimë e fatit të keq dhe as adhurim si hero që ngadhënjën

Nga parathënia për librin "Porosia e kullës"

Rrugëtimi shpirtëror dhe social i Pashko R. Camajt në librin e tij me kujtime

Nga Besnik Mustafaj



mbi vështirësitë. Nuk është modesti nga ana e tij. Është tregues i asaj, të cilën Diogjeni e quante arritjen më të vështirë për njeriun: njohja e vetvetes.

Kështu, *Porosia e kullës*, njëherësh *Ëndërrime nga bagazhi i një veture amerikane*, është pikërisht përshkrimi i rrugëtimit të brendshëm, domethënë shpirtëror, por edhe atij të jashtëm, domethënë social, që Pashko R. Camaj ka kryer deri më sot për të njohur veten. Është një rrugëtim që vazhdon. Vetë protagonist-autor, me mënyrën si e sheh horizontin, drejt të cilit përparon, na lë qartë të kuptojmë ne, si lexues, se ai jo thjesht për arsye të moshës, por më së pari për arsye të filozofisë udhëheqëse për jetën e vet, nuk e sheh

aspak të përmbyllur as rrugëtimin e vet të brendshëm, atë shpirtëror dhe as rrugëtimin e jashtëm, atë social. Një vetëdije e tillë frymëzon energji të mëdha shpirtërore, besim të madh në vete e në mjedisin shoqëror përreth, optimizëm po aq të madh dhe vullnet të fortë për të luftuar vetëkënaqësinë, duke synuar pareshtur për të dhënë më të mirën e vet.

Vijmë kështu te kuptimi i titullit të librit në shqip, *Porosia e kullës*, të cilin unë e kuptoj si "amaneti i kullës". Në jetën e shqiptarëve të Veriut, kulla është njëherësh një simbol i rëndësishëm së veçantë dhe një realitet konkret. E tillë na shfaqet ajo edhe në jetën e Pashko R. Camajt. Si simbol ajo mishëron

identitetin e spikatur shqiptar, me të cilin është mbrujtur brenda familjes protagonistin i prozës në fjalë. Si realitet, kulla përfaqëson shtëpinë, çerdhen, ku edhe është lindur dhe rritur autori, ku ndërthuret përballja e përditshme me hallet ekonomike për të mbijetuar e një familjeje malësore shqiptare me përballjen edhe më të vështirë me rrethanat historike dhe politike për të siguruar mbijetesën identitare shqiptare.

Autori i qaset me ndershmëri dhe pa patetikë përshkrimi të kësaj përballjeje të dyfishtë. Vendlindja e tij, Malësia, është e bukur sa s'ka më, por e lënë krejt jashtë rrjedhave të zhvillimit ekonomik. Për pasojë, mundimi i malësorëve për të siguruar bukën e përditshme është shumë i madh. E gjithë familja, përfshirë edhe fëmijët, është në punë nga mëngjesi në mbrëmje. Parë nën këtë dritë, përshkrimet e këtij libri përbëjnë një lëndë të dobishme edhe antropologjike për të njohur jetën e zakonshme të një familjeje malësore shqiptare në Mal të Zi gjatë viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar. Po them kështu se, gjatë shkrimit, autori është kujdesur mirë për t'i dhënë tekstit të tij një dimension dëshmie, e cila e kapërceu megjën e oborrit të kullës së Camajve, duke e bërë natyrshëm kujtesën e vet individuale pjesë të kujtesës kolektive të bashkësisë etnike, ku e ka sjellë fati.

Në përballjen tjetër, atë për të ruajtur e për të përcjellë brez pas brezi identitetin shqiptar, kulla familjare shërben si fortesa stërgjyshore, ku mbrohen dhe ushqehen traditat e lashta, zakonet e mira, virtytet morale, të cilat jashtë oborrit të saj janë gjithë kohën nën një agresion të shpallur e të pashpallur, të hapur apo tinëzar. Pashko R. Camaj është një nga shqiptarët e Malit të Zi. Malësia, prej nga vjen ai, është pjesë autentike e Malësisë së Madhe, e prerë mizorisht si me shpatë nga trunngu, nëpërmjet kufirit shtetëror të vitit 1913. Jashtë vullnetit të tyre, këta malësorë shqiptarë u gjendën në shtëpinë e tyre, por në një shtet të huaj.

Mospajtimi i malësorëve shqiptarë me këtë paracaktim fillonte brenda kullës dhe synonte të përhapej edhe jashtë, qoftë edhe duke paguar një çmim shumë të shtrenjtë, siç ndodhi me gjyshin e autorit, të cilin ushtria e shtetit të huaj e mori në pragun e shtëpisë së vet dhe e pushkatoi

PASHKO R. CAMAJ

Porosia e kullës

Parathënie nga Besnik Mustafaj

OnufriKujtime



mizorisht. Pashko R. Camaj, me dëshirën e ndershme për ta shprehur me të gjitha nuancat të vërtetën e këtij "mospajtimi me paracaktimin", hedh dritë edhe te shpresa që ngjalli tek ai, domethënë te brezi i tij, që ishin nipërit e të pushkatuarve nga shteti, parulla e regjimit titist për ta shndërruar Jugosllavinë në atdhe të "bashkim-vëllazërimit" të popujve. Në pamundësi për ta kthyer mbrapsht rrotën e historisë, ky brez shqiptarësh djalosharë shpresoi se ishte gjetur një mënyrë që "kulla" e tyre të merrte frymë lirisht, duke u ndier jo vetëm në truallin e vet, por edhe në shtetin e vet. Ata ishin gati ta linin pas të shkuarën e përgjakshme ndëretnike, por pa lëshuar në identitetin e tyre shqiptar, për të cilin kishin dhënë jetën gjyshërit. Paraqitja e zhgënjimit nga kjo demagogji komuniste nëpërmjet përshkrimit të fakteve të jetuara nga protagonistit dhe jo si një opinion i autorit përbën një pasuri të veçantë të librit.

Ashtu si "kulla" në titullin e botimit shqip, edhe "bagazhi i veturës amerikane" në botimin anglisht ka një domethënie të shumëfishtë, edhe faktike, edhe metaforike. Protagonisti ka hyrë në SHBA pa letra, i fshehur në bagazhin e një veture amerikane, si emigrant i paligjshëm. Ai ishte njëzet vjeç, në moshën e shpërthimit më të bukur të ëndrrave për të ardhmen dhe po aq të shpërthimit të energjive për t'i përmbushur këto ëndrra. Ai kishte kryer shkollën e mesme si dhe shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Kishte një përvojë të mjaftueshme jetësore si dhe pjekurinë për ta kuptuar se Mali i Zi, përkatësisht Jugosllavia, nuk ishte vendi për përmbushjen e ëndrrave të djaloshit shqiptar për të ndërtuar një të ardhme. Ai kishte dy zgjedhje: ose t'i nënshtrohej fatit, të qëndronte në vendlindje, për të vazhduar luftën e mbijetesës, duke ecur në gjurmët e babait, ose të zgjidhte një vend tjetër, ku të gjente lirinë për t'i kthyer ëndrrat në vepër.

Pashko R. Camaj zgjodhi të dytën. Udhëtimi i shkurtër, por aq i anktshëm në bagazhin e veturës amerikane për kalimin e kufirit nga Meksika për në SHBA përmban frikën e natyrshme nga kontrollet e policisë kufitare, por jo frikë për të ardhmen e panjohur që e priste. "Kulla" e kishte mburjtur me të gjitha cilësitë e nevojshme morale për t'u përshtatur me hapësirën e lirisë, ku po shkonte. Libri i shkruar afro dyzet vjet pas atij udhëtimi na tregon sa e drejtë kishte qenë në zanafillë ajo zgjedhje. Kthimet e mëvonshme te "kulla" janë në përmbajtje pelegrinazhe që ai bën në vendin e tij të shenjtë për t'i pohuar vetes dhe trashëgimisë së tij se rrënjët e tij janë aty ku kanë qenë gjithmonë, tek ato themele ku është derdhur gjaku i gjyshit dhe djersa e ndershme e babait.

Pashko R. Camaj e ka letrarizuar rrëfimin e tij veridik. Në vlerësimin tim ai ka bërë zgjedhjen e duhur për t'i dhënë rëndësi gjuhës, duke ndërtuar atë që quhet "stil". Kjo është në dobi të lexuesit, i cili do të përfshihet në lexim me një kënaqësi të shtuar.

(Vijon nga faqja 3)

sigurojmë aplikimin e rregulloreve që mbrojnë shëndetin dhe sigurinë e punonjësve tanë, por edhe atë të përdoruesve të sistemit tonë. Është e rëndësishme të theksohet se pozicioni im i parë në këtë agjenci ishte si një specialist i nivelit fillestar me pagë relativisht të ulët. Por kalimi i viteve dhe arritja e niveleve të arsimit, siç ishte diploma e doktorit, më katapultoi karrierën time dhe më bëri të ngjisja shkallët administrative në agjencinë shtetërore. Përveç kësaj, unë jam profesor kolegj në Universitetin Uilliam Paterson këtu në Nju Xhersi, ku u mësoj studentëve shëndetin publik dhe epidemiologjinë. Herë pas here, kemi studentë që janë me origjinë shqiptare. Kështu që, sa herë që vërej ndonjë shqiptar në një klasë, ia filloj duke thënë se kushdo që mund të shqiptojë saktë emrin tim, do të marrë pesë pikë shtesë në notën e tyre përfundimtare. Pa dyshim, studenti shqiptar do ta bëjë pa gabim, në kundërshtim me atë amerikan. Ata e thonë emrin tim dhe e shqiptojnë pak më ndryshe, pothuajse duke e bërë atë të tingëllojë si një lloj emri francez (Kamazh).

Do të doja të flisnim për kontributin tuaj në Federatën Panshqiptare të Amerikës "Vatra". Nga një anëtar i thjeshtë i saj, pastaj nënkryetar dhe tani sekretar i përgjithshëm.

Po, kjo është një gjë shumë e dashur, e shtrenjtë dhe e çmuar për mua. Për Federatën "Vatra", për organizimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të saj për kombin tonë, kisha dëgjuar që nga hera e parë që erdha në Nju-Jork dhe gjithmonë më tërhiqte drejt saj. Euforia rreth festimit të njëqindvjetorit të "Vatrës" në vitin 2012 më entuziazmoi dhe u bëra anëtar, fillimisht një anëtar i thjeshtë, si thoni edhe ju, pastaj anëtar i kryesisë, nënkryetar dhe tani sekretar i Federatës. Ne përpiqemi të bëjmë më të mirën që mundemi me një organizatë që ka histori kaq të lavdishme, por duke ditur se gjithçka që bëjmë është e bazuar në vullnetarët dhe ata që duan të kontribuojnë herë pas here, kemi edhe vështirësi. Të jesh një nga bordi ekzekutiv i "Vatrës" është gjë shumë e



Me Lezen dhe Dritën, 1995.

rëndësishme, është historike. Por ajo vjen me një ndjenjë përgjegjësie dhe përkushtimi ndaj shumë ngjarjeve dhe aktiviteteve ku ne mund të deklarojmë me krenari anëtarësinë tonë, të ndërlidhur me historinë e saj. Gjithashtu, dhe po aq e rëndësishme, veprimet tona për t'u përpjekur të bindim ata që kanë një ndjenjë patriotizmi që t'i afrohen "Vatrës" janë një gjë fisnike dhe patriotike. Është në misionin tonë të inkurajojmë në veçanti të rinjtë për t'u bashkuar dhe për t'u gjendur më afër Federatës "Vatra", që është historia, identiteti dhe krenaria e shqiptarëve të Amerikës.

Pa hyrë shumë në çështje politike shqiptare, kur te "Vatra" vijë delegacione nga trevat tona, a ndiheni në siklet kur mosmarrëveshjet tipike tonat mbërrijnë deri te ju? E bëj këtë pyetje duke pasur parasysh pozicionin delikat si mikpritës të "Vatrës", por pa harruar se, si drejtues të organizatës, keni edhe frymën amerikane, të asaj Amerike që aq shumë ka bërë për kombin tonë.

Historikisht, "Vatra" ka mbështetur të gjitha çështjet madhore kombëtare, që nga formimi i shtetit shqiptar, Lufta e Parë Botërore, ndërtimi dhe konsolidimi i shtetit shqiptar, njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Shqipërisë, lufta kundër komunizmit, ndërtimi i marrëdhënieve me Amerikën, lufta e Kosovës dhe Pavarësia e Kosovës. "Vatra" është histori dhe lavdi. Ajo ishte qeveri shqiptare në mërgim. Nuk është një parti politike dhe ne nuk do të lejojmë që ajo të bëhet e tillë. Partia jonë politike

është flamuri kuq e zi, është patriotizmi dhe përkushtimi ynë ndaj kombit tonë, ndaj çështjeve tona kombëtare, pra për mirëqenien tonë si komb, si popull e si shtet. Ne, si të tillë do të vazhdojmë të jemi një zë i fortë kudo që zëri ynë është i nevojshëm, duke ruajtur miqësinë dhe partneritetin tonë me institucionet tona amerikane, siç janë Departamenti i Shtetit, Senati, Kongresi Amerikan dhe Shtëpia e Bardhë.

Doja ta mbyllja këtë intervistë, i dashur Pashko, me një pyetje, përgjigja e së cilës do t'u interesonte absolutisht shumë kolegëve të mi botues, por edhe shkrimtarëve shqiptarë, duke pasur fatin që tani jeni edhe vetë autor. Çdo vit në Amerikë shtohet numri i madh i shqiptarëve, pjesa më e madhe e të cilëve janë, pa dyshim, lexues të mirë. Pyetja është, si mund të eksportojmë në Amerikë librin shqip, ashtu sikundër kam mësuar se eksportohet me sukses birra, djathi, sallami etj.? Me fjalë të tjera, how to follow the albanian speaking readers?

Mendoj se kjo është një pyetje shumë e mirë dhe duhet të punojmë shumë për të bërë diçka që të sigurohemi që kjo të bëhet e realizueshme. Siç thoni ju, ne blejmë këtu produkte shqiptare, dhe pse jo libra. Dija është liri, liria është jetë. Kjo gjë duhet të jetë e realizueshme mjaft lehtë. Çështja është se a duhet të punojmë vetëm për të gjetur një vend apo dyqan në secilin prej tregjeve më të mëdha, si në Nju-Jork, Detroit, Boston, Filadelfia, Çikago etj. ose, një mënyrë tjetër ndoshta, të përpiqemi të arrijmë deri te kontaktet tona dhe të bisedojmë me librari të tilla, si "Barnes & Noble", që të shohim nëse ka një interes dhe nëse po, dhe ka një fitim për t'u bërë, gjithmonë do të ketë njerëz që do të donin të blinin libra. Kjo është diçka për të cilën organizata të ndryshme shqiptare, që janë të shumta në numër, mund të vijë në ndihmë për promovimin e këtij procesi, që disa nga qytetet apo vendet tona ku ka shumë shqiptarë të mund të blejnë librat e botuar në shtëpitë botuese në vendlindjen tonë. "Vatra" do të kontribuojë në këtë proces të rëndësishëm kulturor, patriotik dhe komunitar.



Unë dhe Drita, gati për foton e pasaportës, 1984.



Një javë pasi unë dhe Sonja u martuam, 2 nëntor 1986.

Shumë rrëfime shqetësuese për shumë ngjarje të vërteta. Historitë e fateve njerëzore që i sjell autorja e librit SHPRESË E VENITUR, Delvina Kërluku, do të prekin thellë ndjenjat e të gjithë atyre që do t'u bie në duar ky libër. Mbase, thelbi i fjalëve dhe fjalive të shkruara pasi ta lexosh këtë libër, të çon të mendosh se çfarë do të thojë e do të bëjë për t'u ndihmuar këtyre njerëzve në nevojë.

Libri vjen me një stil autorial dhe një narracion shumë të qartë, që nga titulli, që është edhe vet mesazhi shqetësues për dramën sociale dhe psikologjike të njeriut të pashpresë. Libri "Shpresë e venitur", është i organizuar mirë dhe i shoqëruar me një sërë faktesh për ngjarjet dhe personazhet që shfaqen në të, si histori të trishta të një kohe që po ndodhë aktualisht. Në fillim, zhduket shpresa, pastaj vjen dëshpërimi, rraskapitja fizike dhe emocionale, uria, etja... Të gjitha këto, që për ironinë e fatit, janë pjesë e këtyre dramave familjare, nuk iu shpëtojnë klithmave të vuajtjeve të tmerrshme. Ky libër, zbulon probleme të shtresuara, por në të njëjtën kohë, nxjerr në pah edhe distancimin e heshtur të shoqërisë. Tmerri i portretizuar si një ogur i zi, në mënyrë eksplicite, lë të kuptohet se shpresa është ende larg. Saga e vuajtjeve njerëzore, plot tension e dhimbje, ka ndrydhur shpirtin dhe ka prishur fantazinë e tyre.

Nuk jam aspak ihtar i thadrimin të një gjuhe patetike që ua vret humorin njerëzve, por ndjehem i shqetësuar nga stigmatizimi e demonizimi i njeriut të braktisur. Prandaj, druaj për interpretimin e saktë të këtij libri, sakaq që nuk arrij ta shijoj dot leximin e këtyre rrëfimeve kaq drithëruese e rrëqethëse.

Drama njerëzore është e pakuptimtë në këtë shekull. Ajo na kthen pas në kohë. Personazhet në këtë libër, nuk janë kukulla, por njerëz, që jetojnë jetën e tyre të harruar nga institucionet dhe shoqëria. E gjitha fillon me skamjen. E gjithkund ku ka skamje nuk ka lumturi. Pa veçuar ndonjë personazh, sepse thuaja të gjithë janë njësoj, do të mundohem të ndajë me ju atë që na e sjell autorja përmes rrëfimeve të saj në formë libri. Skenat e vërteta janë portretizimi rrëqethës që do të duhej të godiste çdo qenie njerëzore. Gjithçka përreth tyre është përpirëse, e çrregullt, gëluese... Në sytë e tyre lexojmë ankthin dhe frikën. Për ta, çdo ditë gdhinë njësoj. Nuk ka gjë që nuk i shqetëson. Secila histori në vetvete, shpalos ankthin e pritjes dhe të shpresës që nuk do të vijë. U është venitur e këputur në mes shpresa. Njerëz pa çati mbi kokë, ose nën ndonjë çati të huaj, në shtëpi-rrënoja të braktisura. Dridhen nga të ftohtit, uria... Të varfër dhe të sëmurë. Të humbur në errësirë. Do t'u pëlqente alternimi i dritës dhe errësirës. Por, në skutat e tyre nuk depërton drita, aty ka vetëm errësirë. Duan ndihmë, por s'ka kush t'i ndihmojë. Pamje të llahtarshme njerëzore! Askush nuk e sheh dot këtë dhembshuri. Të braktisur nga të gjithë e të lënë në mëshirën e fatit, ata i thërrasin vdekjes. Kjo, është skena më e frikshme e përditshmërisë sonë...

Autorja shprehet e tronditur për heshtjen që ka pllakosur këtë fatkeqësi njerëzore. Asaj, aspak nuk i pëlqen heshtja. Prandaj, nuk do të rresht për t'u bërë zëri kumbues i britmave të këtyre njerëzve, me shpresën se një ditë ky zë do të bëhet kumt i zgjidhjes së problemeve të tyre. Plot pezëm, duke bashkëndjerë dhimbjen, ajo lufton që të mbizotërojë e mira mbi të keqen. Kështu, Delvina, në mos më shumë, të paktën ua lë gjallë ëndrrat.

Më tej, autorja sjell përpara lexuesit ndërgjegjet e fjetura, të atyre që vetëm i konstatojnë pasojat e vërteta të tragjedive njerëzore, por pa ndryshuar gjë. Kaq shumë 'zhurmë', në vesh të shurdhër. Qoftë edhe përmes shprehjesh simbolike ndaj së keqes, autorja nuk mund të qëndrojë indiferente.

"Shpresë e venitur", libri i ri shkrimtares Delvina Kërluku

SKENA E FRIKSHME E PËRDITSHMËRISË SONË...

Nga Dr. Demush Bajrami

Në libër, nuk mungojnë as rrëfimet e shumta që kanë personazhe fëmijët këmbëzbathur e të sëmurë, pa rroba e libra. E, sa për lodrat, ato do të ishin gjëja e fundit për ta. Shpirti i bukur i fëmijëve, akoma duhet të presë për ta gjetur lumturinë.

Ky libër, rrëfim pas rrëfimi, histori pas historie, sikur na vë në siklet, duke na çuar drejt një detyrimi për të pyetur veten: a thua do të vijë dita kur këta fëmijë do t'i kthehen lojës?! Ata nuk dinë se ç'janë dhuratat për festa. Brenda mureve të ftohta, shikon vetëm fytyra të zbehta që gjithnjë të shikojnë me shqetësim. Këto pamje të zymta, kanë detyruar autoren të shpërthejë, duke na treguar se këta fëmijë kanë shumë nevojë për mirësinë e kësaj bote, për pak të qeshura dhe për pak momente gëzimi.

Delvina nuk na lë rehat, duke mos i lënë mënjatë temat që trishtojnë. Ky narrativ nuk ka qenë aspak i lehtë as për vet autoren e librit. Pafuqia, dobësia, dorëzimi, paniku, dëshpërimi, ankthi, vuajtja... ndoshta nuk

janë asnjëherë të vërteta, janë vetëm pasojë e perceptimit tonë, mënyra sesi e shohim, e kuptojmë dhe e përjetojmë veten dhe botën e jashtme. Perceptimi ynë është gjithmonë për shkak të këndvështrimit që ne, me ose pa vetëdije, pushtojmë një pjesë të hapësirës sonë. Mbase, psikologët do të thoshin se problemi lind atëherë kur nuk kemi të vetëdijshëm për këndvështrimin se si e perceptojmë realitetin, sepse atëherë ne nuk arrijmë ta bëjmë dallimin e vërtetë midis realitetit dhe perceptimit tonë mbi atë realitet. Por, këtu nuk bëhet fjalë për perceptimin tonë të gabuar dhe për rolin e viktimës, por për vetë viktimën. Tek këta njerëz nuk shteron ndjenja e pafuqisë. Asgjë nuk ndryshon. Asgjë nuk ua shëron plagët. Asgjë nuk i çliron këta personazhe nga vuajtjet e tyre. Ky është tmerri që ka regjistruar Delvina, e cila sjell përpara lexuesit dhembjet e familjeve që jetojnë në mjerim. Edhe vet ajo, si duket, lufton me veten e saj, teksa kudo ndeshet me


kontrastin e dy botëve që bashkëjetojnë, por që janë skajshmërisht të ndryshme.

Delvina sikur i riaktualizon edhe njëherë vargjet e "Poemës së Mjerimit", ku dominon fati i njerëzve në skamje dhe mjerim. Tek lexuesi do të ketë një efekt kthjellimi lakuriqësia e plotë e dramës njerëzore. Migjeni e kishte ndërtuar poemën e tij nëpërmjet një toni plot mllef kundër kësaj 'të keqeje që duhet zhdukur nga faqja e dheut, se është turp i njerëzimit'. Tek "Poema e Mjerimit", kemi jo vetëm një përshkrim realist të mjerimit, por edhe ndjeshmëri të thellë të unit të brendshëm të poetit, i cili bëhet bashkëvuajtës në mjerim.

Ngjashëm si Migjeni, edhe Delvina revoltohet në këtë pasqyrë skëterrë, me qëndrimin e saj kritik ndaj shoqërisë. Vuajtja, në mënyrë kronologjike, po vazhdon ende..., përgjithmonë prej kohësh...

Dikush do të thoshte: po a nuk iu bind edhe Platoni fatit të tij dhe përsëri vuajti pa u ankuar? Po, sepse në një përplasje me të keqen, gjithnjë në anën e heroit është forca e tij e brendshme, e cila e ndihmon atë të mos dorëzohet, duke u rebeluar kundër autoriteteve.

Për fund, më duhet ta mbyllë me këtë konstatim: ndoshta ky libër, mund të shërbejë edhe si një 'terapi' për lehtësimin e vuajtjeve personale dhe sociale. Për faktin se libri i Delvinës, na flet me një gjuhë që na mëson se gjithçka që duhet të ngjizë në zemrën dhe mendjen e njeriut janë përpjekjet që çojnë në mirëkuptimin dhe funksionimin tonë me të tjerët, duke sjellë më shumë dashuri, dhembshuri dhe jo urrejtje dhe nxitje të dhembshurisë. Jeta është e vështirë, por problemet dhe vështirësitë në jetë e shpalosin guximin dhe mençurinë tonë. E, këto së bashku i japin kuptim jetës sonë.



Derisa është thënë se Shqipëria është vend i çudirave, mbi të gjitha Shqipëria është vend i bukurive artistike, i një bote me krijues të talentuar në art, poezi, dramë, roman, që arritën të ecin edhe gjatë kohërave të oportunitetit, por edhe gjatë proceseve të tjera shoqërore, në liri e në robëri. Këtë lloj koherence të çuditshme të ecjes artistike, që manifeston herë tendosjen e herë shtendosjen e muskujve të pushteteve përballë një populli që kishte vuajtur që nga koha romake e deri në ardhjen e Italisë e të Gjermanisë, shkrimtari dhe poeti Primo Shllaku e shpreh edhe në prozën romanore "Pesha e padurueshme e pafajësisë", me këto fjalë: *Në vend kishte njiilloj mungese pushteti, por gjanat ende shkonin mirë* (f.7). Pra, kishte mbrapshti pafund, por njeriu dhe pesha e rëndesës së tij kishin një karar që ekuilibronte masën e duhur për të shikuar të ardhmen pa frikë *a zor të madh*, siç thonë kosovarët.

Në vitin 2023 Shtëpia e mirënjohur botuese Onufri botoi prozën romanore "Pesha e padurueshme e pafajësisë" të shkrimtarit Primo Shllaku, një shkodoran i rryer, i cili paraqet me mjeshtri jetën e një qytetari shkodoran, të ri në moshë, e të ri përballë virtyteve e epsheve, të ri edhe përballë natyrës që shpurris shpirtin djaloshtar. Pa u ndalur në strukturën e narracionit, pafajësia është motivi që do ta ngarkojë autori në supet e personazhit, si në fillim ashtu edhe gjatë tërë rrugëtimit fikcional. Personazhi i Shllakut nuk është personazh intelektual. Autori përmes tij me të drejtë rrëfen për një pjesë të shoqërisë, të madhe në numër, për të paraqitur vështirësitë dhe kuptimin e jetës për këtë kategori që po kalonte tranzicionin nga një vend i pushtuar drejt një lirie që do kushtonte deri në qëndrakun e fundit. Pra, është shqiptari tipik i cili nuk posedon njohuri të bollshme se çka është duke ndodhur jo vetëm në botë, por as në qytetin e tij, madje as në lagjen pranë.

Në fazën e fundit të sundimit të Italisë pastaj edhe të Gjermanisë, jeta shoqërore kishte një kuptim, së paku kjo është thënë jo vetëm nga ata që e shkruan historinë nën tutelën e kohës, që ishin farefisnuar me bolshevizimin edhe në Ballkanin e çudirave, por edhe nga ata që kishin përjetuar këtë etapë kohore. Shllaku e vë në qendër një djalosh që zotëron një zanat hidrauliku dhe mendoj se kjo është mënyra më e mirë për të kuptuar ankthin, depresionin, epshin, vigjilencën dhe karakteristikat e tjera individuale përballë një gjendjeje shoqërore që po kalonte Shqipëria dhe jo vetëm Shqipëria, por i gjithë Ballkani Perëndimor. Kjo do të mund të përkufizohet me thënien e Kamysë se drejtësia është ndarë përfundimisht nga pafajësia, duke e vendosur këtë të fundit në kryq dhe të parën në raft. Kjo temë do ta rëndojë personazhin fund e krye, por autori kujdeset të krijojë një dramë të tendosur ngadalë. Pra, Shllaku nuk nxiton ta portretizojë me shpejtësi personazhin e tij, sa të ngrysur e indiferent aq edhe të rryer, i cili ngjan me shqiptarin e pavëmendshëm përballë asaj se çfarë po ndodhte përreth e që në përgjithësi, tipat e tillë janë të rrallë te ne.

Përmes kësaj figure sa të çuditshme e aq të mallkuar, por tërësisht të pafajshme, Shllaku jep edhe pasqyrën subjektive dhe objektive jo vetëm të karakterit individual, por edhe atij

Primo Shllaku, *Pesha e padurueshme e pafajësisë*, Onufri 2023


PAFAJËSIA E FAJSHME

Nga Mërgim Bektashi

shoqëror se çfarë do të ndodhte me ikjen e një flamuri pushtues dhe vendosjen e flamurit tjetër që zbriste nga malet me krenarinë e triumfuesit çlirimtar. Kjo nuk do të çlironte barrën e shoqërisë dhe peshën e rëndesës, por do të shtonte hallet dhe do të zhbironte mendimet e kujtimet e një populli. Peshë e rëndesës ishte edhe mallkimi historik përmes brezave të tërë duke ia shkullur shpatullat popullatës së mjerë përmes gjyqeve që të kujtojnë "Procesin" e Kafkës përmes pyetjeve të shpeshta në roman: Çfarë faji ke bërë? (f.172). Nuk e di!, do të ishte përgjigjja jo vetëm e njeriut të rëndomtë, por edhe e shtresës intelektuale. Sado që pushteti i ri kishte zbritur nga malet dhe zotëronin bindjet e ateizmit agresiv, ata prapë kishin frikën e mallkimit. Ata do t'i burgosnin të gjithë, edhe ata që 'zotëronin' fuqi mbinatyrore, sepse i frikësoheshin syrit të keq, pra ky nuk ishte sihariq i mirë për ta, kërcënimeve

të çdo trajte ia kishin frikën, ngado që mund të vinin.

Burgjet, kampet e përqendrimit, shkalla e veprimeve hetimore dhe gjyqet në Emër të Popullit, që mund të ishin gjithçka tjetër, por jo në emër të popullit, do të bëhen objekt studimi në roman. Vuajtjet do të jenë të rënda, tragjike, do të kenë çmimin që flamurtarët e rrejshëm të lirisë kishin vendosur mbi kokat e banorëve, brenda kësaj margjine evropiane të quajtur Shqipëri, mbi një popull të vogël ku çdokush do të japë llogari se përse nuk e rroku pushkën e të ngjitej në mal apo të mbështeste këta çlirimtarë të çuditshëm. Për secilin do të bëhej gjyqi, sikur për Marin Shitajn, i cili duhej ta pranonte fajësinë për fajin që nuk e kishte bërë. Fajësia dhe pafajësia do të rëndonin mbi personazhin, por ai do të gjente motivet për ta shtyre tutje, jeta brenda burgut do t'ia shfaqte peshën e rëndë të një rendi të ri shoqëror në ardhje



PRIMO SHLLAKU

pesha e padurueshme
e pafajësisë

OnufriRoman



e sipër, kur çdokush do të frikësohej kur thirrej emri i tij brenda atyre mureve të improvizuara të burgut, sepse *shiu i butë lag të marrë e të urtë* (f.224); hetimet do të nxjerrin me darë mendimet e tyre, edhe ato që nuk ishin formuar ende, sigurisht se kjo do ta tmerronte edhe Frojden, do ta kalonte edhe Inkuizicionin e Madh, pra ishin çaste të paimagjinueshme kur njeriu lutej të ishte insekt: *Ah, sikur të isha bubrec!* (f.228)

Edhe dashuria është temë e romanit. Shllaku arrin të përshkruajë bukur çaste idili, por edhe të atilla që shkaktojnë thelloma brenda një shpirti të trazuar të një hidrauliku. Shpirti i një hidrauliku tundohet para një gruaje të trazuar e cila vjen dromca-dromca në shpirtin e tij. Tatjana do të notojë lirshëm në mendimet e tij, edhe pse ai i frikësohet forcës së mallkuar që bart brenda vetes, por shpirti i tij është një zgavër që përballë dashurisë turpërohet deri në maje të kokës. Autori shpesh luan me ndjenjat e lexuesit duke menduar skenat në të ardhmen, por ato faniten e bien pre e një malli të pakapshëm. Është edhe mençuri artistike që disa gjëra nga pritshmëria të mbesin vetëm imagjinata për lexuesin, pra efektet morale shpalosin kureshtjen dhe mbesin me pritje deri në faqen e fundit të romanit. Dashuria do ta shkundë hidraulikun sikur truma që donte provën për derdhjen e ujit brenda gypave.

Romani i Shllakut është i ndërtuar me një strukturë të bukur rrëfimi, i kapshëm për lexuesin dhe shohim një gegërishte të përsosur, por edhe struktura të standardit gjuhësor. Shpesh komunikimet kanë një poetikë të bukur, më këtë do të merren njohësit e gjuhësisë për të kuptuar se gegërishtja është pasuri gjithëkombëtare. Secila ndarje në roman përbën pjesë të themelësisë gjuhësore të rrëfimit apo mund të merret si tregim më vete. Këtë përdorim gjuhësor nuk duhet ta kemi frikë, përkundrazi duhet të analizohet me pritshmëri dhe pa ndonjë hezitim.

Romani i Shllakut, aq sa është ndërtuar mbi provat apo dëshmitë e një shoqërie që kishte kaluar një etapë skëterre në emër të lirisë, tregon përvuajtjet politike që popullit ia katandisën mbi supe, për pasojë edhe vetë subjektit të romanit. Pafajësia del si përpjekje e panevojshme përballë aparaturës shtetërore apo, siç thuhet në roman nga të pavuajturit: *Nëse beson se je i pafajshëm, keq e ke punën...* (fq.187). Një shtet i egër, i dalë mode, dinte të krijonte prova dhe të përthithte edhe ëndrrat e qytetarëve të saj, prandaj edhe në ëndrra duhej të kishin kujdes. Këto detaje interesante gjenden të "Pesha e padurueshme e pafajësisë", ku e padurueshmja shpesh bëhet sindromë e shoqërive totalitare.

Kritikë mbi librin "Shtëpia ime rrotullon qiellin" të poetit Dhimitër Pojanaku, botuar në Bukuresht.

SHKËLQIMI I VEPRËS SË HAPUR

Ardian Christian Kçyky



Në dyndjen e sotme të vëllimeve poetike, në këtë uragan letre të shtypur që sikur synon ta çmallë shpirtin e sa më shumë shkrimtarëve me këtë botë, - thua se na pret një tjetër shumë më e egër - duket marrëzi të përpiqesh të zbulosh cila nga qindra llojet e poezisë do t' i qëndrojë kohës dhe cila do bjerret bashkë me ata që e shkruajnë.

Nga kjo pikëpamje, roli i kritikur është tejkaluar ose është ngushtuar po aq sa roli i lexuesit të thjeshtë.

Megjithatë, po të mos lëmë mënjanë "fatin" dhe misterin me të cilin librat e vërtetë arrijnë të ngrihen mbi pjesën tjetër të letrës, mund të themi me bindje se vepra e poetit shqiptar Dhimitër Pojanaku përfaqëson një përjashtim befasues jo vetëm në letrat shqipe.

Ajo që tek shumica e poetëve të tjerë është thjesht mungesë sistemi poetic, - me ravgime të dukshme për ta paraqitur si liri tematrike e stilistike, - tek Pojanaku është **vepër e hapur**.

Kjo vepër e hapur, duke përfituar nga hapësira e pamatë që i ofrohet nga vetë hapja, por edhe nga forca, me të cilën një vepër e hapur pastron mëkatet e veta, të kujton një shpërthim ngjyrash e tingujsh antikë, ose një mozaik të gjallë, që plotësohet vetvetiu qysh nga lashtësia.

Jo rastësisht poeti i shquar kosovar Azem Shkreli, në një letër, e cilësonte lirikën e Pojanakut *si një lirikë që shkruhet vetë, rrjedh vetë*. Kjo vërejtje, pas leximit të lirikës në fjalë, na bind se autori dhe uni i tij poetik shndërrohen në Zë.

Një zë që nuk mbart fort parasysh gjeografinë, shtypjen e ushtruar nga tekat e histories, dhe që zgjatet deri në kufijtë e mbramë të shqipes, aty ku rrijnë të ngjuara fjalët e ndaluara dhe hapësirat e këtyre fjalëve.

Të rrallë janë poetët e shqipes, të cilët e shohin botën me një shqetësim kaq të rafinuar, me një ndjeshmëri që shpeshherë kap paroksizmin dhe që kanë më Vdekjen një afëri kaq të natyrshme. Nga kjo afëri ngjizen imazhe poetikë drithërues dhe me një fuqi të rrallë.

Bjemë ndesh me një harmoni të epërme ku ngjyra tingulli dhe kuptimii fjalës rrjedhin njëherësh dhe mbeten të paharrueshme.

Pojanaku nuk di të qahet, nuk di të ndërkrëhet sipas kanuneve letrare tashmë të mykura, nuk synon të shndërrojë këtë botë të ndërtuar keq, apo të rrënuar mirë.

Hidhërimi i tij krejt i veçantë, thelbësisht poetic, e fton lexuesin në fortesën e Poezisë dhe, që brenda saj, i hap një sy nga ku bota mund të shihet vetëm nëpërmjet shpirtit të poetit.

Me këtë lloj të pari dhe të fljuari mes lexuesit dhe realitetit, Pojanaku shkëputet jo vetëm nga poetët bashkëkohës por edhe nga një pjesë e mirë e paraardhësve.

I vetëdijshëm për rolin shndrues që mund të ketë sot poezia e vërtetë, Pojanaku

nuk e honeps as vetëvrasjem metaforike, - dhe kjo padyshim ngaqë metafora vendoset në shpirtin e të gjitha poezive të tij, - as murgimin elegjik më pamundësi. Ai *thotë, thuhet dhe njësohet* me verbën poetik.

Një nga pikat kyçe të kësaj poezie është çiltërsia fund e krye çarmatosëse dhe aftësia për të mbetur e vetvetishme gjer në shenjat e pikësimit.

Çiltërsia e poetit prek maja të cilave shumë poetë u ndruhen, se mos u sëmur imazhin që ata vetë stërmundohen ta ngjizin nëmendjen e lexuesit.

Pojanaku e pranon haptazi se akti i krijimit poetic, sikurse qëllimi për ligj mjetin, e merr përsipër edhe dështimin, edhe zhgënjimet e përbindshme, edhe kanosjen e përditshme të harmonisë së vvarë, edhe shkëlqimin e veçantë të dhembjeve të pathëna, të plagëve të parrëfyera, madje gjer edhe etjen paranoika për lavdi.

Në krijimtarinë poetike, çdo paranojë dhe çdo flim janë pjesë të së tërës, domethënë janë veti mëse të natyrshme, të lindura të poetit. Fshehja ose arnimi i tyre, e shpjenë lexuesin në qorrsoak.

Vetvetia e lirikës së Pojanakut jo vetëm që nuk e cënon mozaikun fillestar, lindës, por e plotëson dhe i lehtëson frymëmarrjen.

Po i mbyllim këto radhë me një falënderim për kritikun Luan Topçiu, i cili po ia dhuron këtë poet shqiptar lexuesit rumun në një përkthim të denjë për çdo lëvdatë dhe me bindjen se Dhimitëqr Pojanaku, poeti të cilit i *kërkojnë një epitaf për vete*, qysh tani shkon nëpër botë *Imbytur në shkëlqim**, ndonse syri i kritikës letrare, ndofta për faj të askujt, po as për faj të ndokujt, mbërrin jo rrallë me mjaft vonesë tek poezia e vërtetë.



Poezi nga libri "Shtëpia ime rrotullon qiellin"

VAJ QIELLOR

Yjet hungërijnë mbi gurët e varreve.
Qajnë të vdekurit e tokës dhe të qiejve.
Qajnë.
Lëmojnë gurët pafaj,
Ndez in për qirinj iskra farfurie nga trupi i tyre,
Dhe duarmbledhur,
I ruajnë ndezur nga natë e marrë.
Hungërijnë,
Gërvishtin dhenë e ftohtë,

Ciflosin thonjtë,

Dhe lënë mbi varre
Si djaj,

Fanepsje blu.

PRITEN TE DALIN YJET

Seç ka një mister ky qiell
Si grate nën këmishë
Po si` a dogjët gurkalin mantel
U dogj nga stolitë.

ZOGJTË E KORBIT

Ushqyer me thelpinj nate,
Edhe të fundmet, të bardha pendë të gushës,
U nxinë,
Sterrosën.

Tash, u rritën.
Bojë u bënë për zift e për katran.

Tash,
Kraç - kraç,
Do krokasin duke përtypur eshtrat e vdekjes.

Tash,
Nënqielli i madh,
Sqepin e kasaphanës,
Djallëzisht u përkëdhel.

EROS

Pika mavi
Llërës shëtit.
Sa një lajthi
Pika mavi
Aty dhimbje
Ato stoli.

ZHVIRGJËRIMI I MURGUT

Strofkës së çelsit sa të ketrit sy,
Zana e avullt, i shfaqet trup, shpirt.

Flokëpërndezur, hedh cingëla kangjellat e qelës,
Gjinjndërkryer, tylon muret e trashë.
I vë biblën nën jastëk.
Buzë-e-gjuhë,
Trondit mbretërinë e lëmyshkut të kof-shëve.
Duarhark, ja stis vithet rrumbulak.
Me gishtin e madh, dinak,
Nga mesi i zverkut të listë,
tek thembrat,
Nga thembrat, tek dhogat e dyshemesë,
I rrëkëllen një rrëkezë, e ja fringëllon trupin,
Si vesa e shkrirë damarët e gjethit të plepit.
Murgu s` pipëtin.
Llërëplotë,
E puthos pas vetes si rrathët kaden,
Bymen kashtën e shtratshkretit,
E shtrin,
Plandos.

Nuhat triumf!

Nëpër metrotë e nënlëkurave,
Murgut po i hakërrohen qen të tërbuar,
Qen të ndërsyer,
Gati, për t` i shqyer,

Shenjtarinë.

KTHJELLTËSI VERE

Hiqmani këtë qiell, u përgjërohem!
Ka tërë verën s'më lë të vë gjumë në sy
dhe s'mund të kap dot

një ëndërr.

Ky qiell ndien dobësinë time për të bukurën
dhe luan me mua,
Edhe më zbukurohet,
Bëhet i tejpushëm si gjeth në muzg,
I tejgqyrshëm si vesë,
Çjerr këmishën e më lë ta lexoj gjer në fund,
Ta dashuroj gjer në ind!
Hiqmani,
Ky qiell braktisi kubënë e vet,
Nga dritarja hyri në dhomë,
U shtri mbi mua,
Po më mby!
Askush nuk më dëgjon?
Të gjithë qenkan shurdhuar këtë natë?
Epo në është e thënë të vdes prej këtij qielli,
Ashtu u bëftë!

UDHËKRYQ

Rrugë të verbra,
Dete të verbër.
Edhe qiellin,
Të vetmin sy,
Si qiklop, in,
Ma qorruan.
Dhjetëra piratë
Me nishane të zinj prej gjaku të zi,
Me kafka të gjalla për hajmali,
Po zbresin thellë brenda meje,
Dritën e vobektë të shpirtit tim
E paskan marrë për
Perlë,
E vinë ta vjedhin,
Grabitin.
Jam tkurrur si iriq e,
Dridhem.

MACJA NË DIELL

Dremit.
Barkun, si torbë e zbrazur, ja ka lëshuar tokës.
Ka braktisur gjuhët e njomështa të ko-televe,
Dhe thithkat e gjirit,
Nga dëshpërimi,

Skuqin si thana mbi miell.

Herë-herë,
Shtrin këmbët e drobitura,
Dhe me gishtinjtë brisk,
Gërvisht dhe shtie në ngasje lëkurën zhguall të tokës.

DO EDHE SHUMË TË ZBARDHË

Kam një thellë hënë, pjepër, të butë.
Netëve, ngrihet si somnambul,
Me ajkën e sqfurt,
Llaptin pjesën e errët.

Zbut kujtimin e ëmbël,
Cimbis kujtimin e hidhur,
Platit mëkatit e bërë
Nxit mëkatit që pret të bëhet.

Si syploti të verbërin,
Shëtit të vdekurit e mi
Nga mbretëria e hijeve
në hemisferat e dritës.

Kujtime të hidhura,
Mëkatet të pabëra
Të vdekurit e gjallë,
Përsillen brenda meje
si tymi brenda dhomës,

Qorruar,
Ulërijnë,
Kërkojnë shpëtim,

Përplasen katakombeve të shpirtit tim,
Një pjesë prej përplasjes,
Kthejllohen,
Gjejnë shteg,
Marrin udhë.

Një pjesë, shushatur vërtiten dhe vërtiten.

LAJMI:

Çmimi letrar për poezinë, “*Camaiore - Francesco Belluomini*”, që jepet ndër vite në Itali, është i njohur dhe i rëndësishëm, sipas kritikëve, është institucioni i vlerësimit që i kushtohet tërësisht veprave më të mira, të botuara në Itali, jo vetëm të autorëve italianë, por dhe poetëve nga bota.

Janë nderuar me këtë çmim – njoftohet, - poetë italianë si Alda Merini, Alberto Bevilacqua, Corrado Calabrò, Maria Luisa Spaziani, Dante Maffia, Davide Rondoni, etj, dhe nga bota Shenjtëria e Tij Papa Carol Wojtyła, poeti rus Evgenij Jevtushenko, rumunia Anna Blandiana, suedezi Kjell Epmark, nikaraguani Ernesto Cardinal, prift, etj, e deri te nobelisti irlandez Seamus Heaney.

Media italiane i bëri jehonë ecurisë së kësaj ngjarjeje. Bëri të njohur jurinë, të kryesuar nga Michele Brancale - studiues, gazetar dhe poet, Cinzia Demi – poete, Simone Gambacorta, Federico Migliorati, Renato Minore, Ottavio Rossani e Luigia Sorrentino, personalitete të letrave, kritikë arti, poetë, studiues.

Ndërkaq do të ishte dhe një juri tjetër popullore, që në ditën e ceremonisë së dhënies së çmimit, mes publikut pjesëmarrës, do të nxirrte me votim mes 5 kandidatëve një fitues.

U shqyrtuan botimet nga prilli 2022 deri në mars 2023. Mes përzgjedhjes së 150 librave me poezi, u seleksionuan 25 prej tyre dhe dolën 7 poetë kandidatë nga bota për Çmimin Ndërkombëtar:

- Joao Luis Barreto Guimaraes, “*Movimento*” (Edizioni Kolibris) – Portugalia,
- Andrea Cote, “*La rovina che nomino*” (Edizioni Fili d’Aquilone) – Kolumbia,
- Edmond Neagoe, “*Una visione dell’apocalisse*” (Terra d’Ulivi Edizioni) – Rumania,
- Martin Rueff, “*Icaro grida in un cielo di creta*” (Samuele Editore) – Franca,
- Zoe Valdés, “*Anatomia dello sguardo*” (Edizioni Il Foglio) – Kuba,
- Sarah Zahid, “*Non scordiamoci mai quanto può essere bello vivere*” (Edizioni Kolibris) – Norvegjia,
- Visar Zhiti, “*Strade che scorrono dalle mie mani*” (Puntoacapo Editrice) – Shqipëria.

Në votimin e tyre më të fundit, juria profesionale për vitin 2024 shpalli fitues poetin shqiptar Visar Zhiti për librin me poezi “*Strade che scorrono dalle mie mani*” - “*Rrugë që rrjedhin nga duart e mia*”, botim nga “*Puntoacapo Editrice*”, në dy gjuhë, shqip dhe italisht, përkthyer nga Profesor Elio Miracco.

Lajmin e dhanë juria e çmimit, Komuna e Camaiores, më pas Agjencia Kombëtare e Shtypit Italian ANSA, u përhap në mediat e tjera, shkruajtën revista e PEN Clubit Italian deri dhe gazeta më e madhe italiane, e përditëshmjja “*Corriere della sera*”.

Jehonë pati dhe në median shqiptare, u botua në gazetën “*Panorama*” në Tiranë, ndërsa televizioni “*Vizion plus*” i mori një intervistë Visar Zhitit dhe shkruajtën gazetën shqip të diasporës nëpër botë.

PËRURIMI NË MILANO:

Botuesi “*Puntoacapo*” caktoi një ditë për të përuruar në Milano librin fitues, “*Rrugë që rrjedhin nga duart e mia*” me praninë e autorit Visar Zhiti...

U mblodhën lexues të shumtë, poetë, gazetarë, italianë dhe shqiptarë, kishin ardhur dhe nga qytete të tjera, mes tyre dhe një bashkëvuajtës i Visarit në burgjet e diktaturës në Shqipëri, tani me banim në Itali, studiuesi, kritik letrar Eugjen Merlika, i cili do ta niste kështu shkrimin e tij, që do të botontenë gazetë “*Dielli*” në SHBA:

KRONIKA E NJË ÇMIMI, CAMAIORE 2024, FITUES VISAR ZHITI.

Përgatiti Eda Agaj Zh.

“Më datën 19 shtator, në orën 18.00 në Shtëpinë Muze “*Tadini*”, në rrugën N. Jommelli 24, Milano, u zhvillua një mbrëmje kulturore, me rastin e promovimit të vëllimit me poezi “*Rrugë që rrjedhin nga duart e mia*”/“*Strade che scorrono dalle mie mani*”. Autori i vëllimit është poeti i mirënjohur Visar Zhiti, shkrimtari më përfaqësues i letërsisë shqiptare sot në botë...

Madje njëra nga antaret e Jurisë së Çmimit Camaiore, Cinzia Demi, kishte ardhur vetë për t’u paraqitur librin në Milano, - vazhdon shkrimin e tij Eugjen Merlika.

Në drejtimin e promovimit t’asaj mbrëmjeje ajo shoqërohej nga e zonja e shtëpisë, gazetarja arbëreshe Melina Scalisse, që... ishte krenare për origjinën e saj. Ajo, mbas vitesh pune në gazetën “*Il giorno*”/“*Dita*”, kishte në kujdes Shtëpinë Muze Hapësira Tadini, një personalitet i njohur i kulturës së qytetit të Milanos, një poet e piktor modernist, që e kishte lënë shtëpinë e tij si një muzeum për qytetin e tij...”

Melina Scalisse ndali te gjuha, te misteri i fjalës së Zhitit, që ajo ia njihte rrënjët dhe e ndjente si frymë dhe histori.

“...shkrimtari Zhiti iu përgjigj disa pyetjeve të organizatorëve, profesor Mauro Ferrari, poet e Cristina Daglio, ndërkohë dhe bouesit. Ai, - thekson Merlika, - u përgjigj shkurt e me dhimbje, duke treguar disa nga

çastet më të vështira të jetës së tij, siç ishin ato të arrestimit, të dënimit e të qëndrimit në kampet e punës së detyruar, që ishin dhe ato që përcaktonin burimin e frymëzimit për një pjesë të mirë të poezive të vëllimit.

Një përimtim të thukët të përmbajtjes së vëllimit e bëri në mënyrë bindëse profesor Ferrari, që dukej se ishte mjaft i prekur nga drama jetësore e poetit shqiptar. Ai analizoi disa poezi, duke u ndalur më shumë, jo vetëm në përmbajtjet, por edhe në disa terma të hasura më shpesh si atdheu, liria, udhëtimet, etj.

Nga salla do të ngrihej të fliste dhe padre Gianni Criveller, njohës i thellë i persekutimit të poetëve në Lindje dhe Kinë, ku ka shërbyer si misionar. Ndër të tjera ai tha se vuajtja njerëzore është kthyer në vlerë poetike. Këtë theksoi dhe poetja bjelloruse Lara Putsileva.

Edhe Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në Itali, Skënder Lazaj do të nxirrte përshtypjet e tij nga takimi:

“...Nisemi nga Brescia, së bashku me antarët e LSHASHI, Ndue Shabaku, Valbona Jakova dhe poeten Daniela Dante, promovonte veprën e tij Antarë i Nderit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Itali!...”

Takimi i përzemërt me Visarin dhe me zonjën e tij Edën, që sa emocionues aq dhe i ngrohtë, mes një atmosfere arti, ku veç

poezisë aty ekspozoheshin pikturat e autorit Tandini, por dhe të autorëve të tjerë, mes tyre dhe të piktorit të famshëm shqiptar Ibrahim Kodra.

Aktiviteti çelët me prezantimet, dhe natyrisht me përshkrimin e jetës së autorit dhe veprës së tij letrare.

Drejtoresha e Muzeut, gazetarja Melina Scalise, bëri një analizë të veprës dhe fjalës poetike në veçanti, ku evidentoi forcën e fjalës dhe në kushte izolimi, shpirtin e paepur të autorit dhe forcën e besimit, i cili i rezistoi edhe mizorive të regjimit.

Atmosferën e elektrizuan recitimet në shqip të poezive të Visarit nga Eda, kaq bukur dhe aq ëmbël derdhej poezia e tij dhe në italisht, recituar nga poetja italiane Cinzia Demi.”

I rikthehem shkrimit të Eugjen Merlikës, ja ç’shton ai:

“...duke patur në dorë vëllimin, lexohej në kapakë dhe kjo shprehje nga shkrimtari i madh Italian, Umberto Eco:

‘Shihni... ndodhia e Visar Zhitit, që i mjaftoi të shkruante poezi, të quajtura “*të trishtueshme dhe hermetike*”, pra armiqësore për regjimin dhe fitoi me të drejtë dhjetë vite burg. Poezia i shtie frikë regjimeve autoritare e diktatoriale, edhe se flet vetëm për trëndafila, si në rastin e Zhitit.’

Dhe më pas:

‘Visar Zhiti është shkrimtari shqiptar, jeta e vepra e të cilit janë pasqyra më e mirë e historisë së Vëndit të tij.’ Poshtë këtij vlerësimi ishte në kllapa: (Robert Elsie, albanolog kanadezo-gjerman).

Në tridhjetë vitet e fundit janë të shumtë vlerësimet e poetit e shkrimtarit madhor shqiptar nga përfaqësues të ndryshëm të kulturës e letërsisë shqiptare e të huaj të vëndeve ku veprat janë përkthyer e botuar, por mendoj se kjo shprehje e studiuesit kanadez është një nga pikat kulmore, ku Visar Zhiti njëjtësohet me atdheun, një koncept që gjindet shpesh në vargjet e tij, në format e të shkruarit për të shkruarën, të sotmen e për të ardhmen e tij’.

“Duke përmbyllur analizën, botuesja Cristina Daglio iu drejtua poetit: “Ndërmjet të gjithë koncepteve të trajtuar në poezitë





tuaja, cili do t'ishte ai më domethënësi, më qëndrori, më përfaqësuesi...?

Poeti, mbas një çasti përsiatjeje, u përgjigj: Dashuria.

Salla shpërtheu në një duartrokitje të gjatë e të fuqishme. Mendoj se ishte çasti kulmorn i mbrëmjes, thelbi dhe kuintesenca e saj. Me atë pohim poeti shpalli vlerën universale të veprës së tij, që është e barazvlerëshme me vetë jetëgjatësinë e mesazheve që i përcillen lexuesve shqiptarë, italianë, evropianë e botërorë."

CEREMONIA NË CAMAIORE:

"Ndarja e çmimeve do të zhvillohet gjatë një mbrëmje në këtë shtatori me të ftuar fituesin, Visar Zhitit, - shkruante Eugjen Merlika, - në Camaiore, një qytet i lashtë mesjetar në breg të detit Ligur, një komunë prej 31776 banorësh, në provincën e Lukës në Toskanë, e njohur për bregdetin e bukur të saj, për kishat e saj mesjetare, muzeumet e traditën e qilimave".

Nga dritaret dukej deti si një poemë e kaltër përjetësie. Rrugëve ishin vendosur pllakatet "Camaiore është poezi". Në sallën e madhe vinin vazhdimisht njerëz. Në krye ishte një ekran dhe shfaqeshin librat dhe emrat e autorëve.

Që në fillim veprimtarinë e përshëndetën Kryetari i Bashkisë së qytetit, Marcello Pierucci dhe Raffaella, vajza e themeluesit të këtij çmimi, e poetit Francesco Belluomini.

Gazetarë të televizionit vendas filmonin takimin dhe merrnin në intervista poetët që ftoheshin në skenë. Nga sipër vinin ndriçimet, ndryshonin ngjyrë si emocionet dhe binin mbi fletët e poezive...

Presidenti i jurisë profesionale, Michele Brancale, thirri si fitues të Çmimit Ndërkombëtar Visar Zhitin. Motivacionin e dhënies e lexoi poetja dhe anëtarja e jurisë, Ciznia Demi:

SIRENEU MODERN I KRYQIT

"Poetika e "Rrugëve që rrjedhin nga duart e mia" të Visar Zhitit, një libër i botuar dygjuhësh shqip-italisht, riprodhon më së shumti historinë e poetit, një prej të paktëve të mbijetuar të burgut, të mbyllur për të punuar në minierat shqiptare nën regjimin e Enverit Hoxhës: faji i tij ishte se kishte shkruar vargje të dhimbshme, të papërshtatshme për lëvdatat pushtetit. Zhitit nuk hoqi dorë nga kënga edhe në burg, vazhdoi të kapej pas poezisë, prostitutës që më denoncoi në polici. - siç e ka përkufizuar ai në një intervistë - dhe duke mos pasur letër ku të vazhdonte të shkruante tekstet, vargjet u mësuan përmendësh nga ai dhe të burgosurit e tjerë, në mënyrë që ato të mbeteshin, nëse ai nuk do të mbetej gjallë.

Në këtë vëllim i ripërkohet ato vite, pa asnjë venë urrejtjeje. I tradhëtuar nga poezia, Zhitit nuk i vjen keq kurrë për veten, por për njeriun që vuajti, për të ngjashmin e tij që i kanë shkaktuar vuajtjet.

Në poezinë e tij nuk është vetëm përplasja mes një regjimi tiran dhe poetit, por diçka më e keqe: njeriu kundër njeriut. Duke përquar mundimin dhe dhimbjen e të tjerëve, por duke derdhur lotët e tij, mesazhi poetik i Zhitit bëhet universal dhe i kalon kufijtë gjeografikë të dhimbjes shqiptare, duke e bërë atë dëshmitar të vuajtjeve të njerëzimit. Ajo e Zhitit është një litani laike, por vargjet e tij përshkohen nga një ndjenjë besimi e shqetësuar që gjen në simbolin e Kryqit martirin e shëlbimit dhe zbulohet në Krishtin dhe Nënë Terezën: ai nuk e paraqet veten si vuajtës në fundit të dënuar të atij regjimit, por si një Sirene i kohëve moderne që merr mbi vete kryqin e të gjithëve".

Visari kishte thënë që poezia iu bë dhe Madona që e ndihmoi të shpëtonte. Poezia e tij ishte ditari i tij shpirtëror.

Kryetari i Bashkisë, Francesco Pierucci, i dorëzoi Çmimin. Aktorët Alessandro Bertolucci dhe Giulia Battistini recitonin poezitë.

Duke falenderuar, Zhitit theksoi se e ndjente fort që ishte në vendin e Dantes, mbase poeti më i madh i të gjitha kohërave, që na dha me vargje jo vetëm Ferrin, nëntokën e dënimeve, por edhe Parajsën, që patjetër i jep shkëlqim qiellor dhe e bën po aq të rëndësishëm, se letërsinë e ushqejnë po aq sa dhimbja, edhe lumturia, ndërsa unë nga shkaku i poezisë e kalova ferrin tim dhe ajo ndërkaq më hodhi në një parajsë të saj...

Ndërkaq juria popullore mes 5 kandidatëve të poezisë italiane nxori fitues aty poetin Stefano Dal Bianco me librin "Paradiso". Parandjenjë e Visarit apo ndikoi kur foli ashtu?

U ndanë dhe çmime të tjera e mirënjohje. Më pas të gjithë dolëm në kopshtet e bukura aty, buzëdetit tej si copëza parajse dhe Visarit i kërkoni autografe pranë shatërvanit nën drita dhe nën ujëvarën hënore. Edhe libri vetë dukej si i mbështjellë me hënë, me atë kopertinë ku ishte një profil, vepër e piktorit Maurizio Caruso, "Mendim rinor".

Dhe përsëri gazeta Corriere della Sera" e këtyre ditëve kishte në faqen kryesore të kulturës një shkrim me fotografi me titull: "L'Albanese Visar Zhitit vince il Premio Camaiore: compose versi in carcere".

Të bësh poezi në çdo burg, të dukshëm dhe të padukshëm edhe kur s'të lenë, krijo dhe me mend, me çastin tënd. Ai mendim rinor për jetën të jetë i përhershëm, me ato ndjenja dhe pasion si vetë poezia...

Ndërsa gazeta italiane "La Nazione" shkrimin e saj të tanishëm e titullon: "Në Camaiore fiton Poezia si gjuhë e paqes".

Se koha është e shqetësuar, lufta çuditërisht po gjëmon andej-këtej në glob, ajo s'është kurrë larg kur vriten njerëz me mijëra, mes tyre fëmijë dhe poetë, copërlohen dhe poezitë, digjen në ajër nga bombat dhe raketat. Njerëzimit i duhet të flasë patjetër gjuhën e paqes.

ENVER KUSHI

Khaxhai im Jakup në Çamëri

(Rrëfim në vargje)

I largët m'u duk ai zë,
Sikur vinte nga qiejt pa re të korrikut,
Si zë ëndrrë ishte ai zë,
Në ëndërr jam, në ëndërr flas,
Xhaxha Jakupi më tha.
Po trokas, po trokas, po trokas.
Dera e shtëpisë, ku kam lindur,
E kyçur në Spatar është.
Trokas e trokas, po derën askush s'ma hap.
U drodha nga zëri ëndërr i xhaxhait Jakup.
Të fala ke më tha. Të fala.
Më erdhën shpirtrat e tyre këtu,
Edhe gjyshe Hazbua, edhe gjyshe Izet,
Edhe xhaxhallarët e mi këtu janë.
Të fala, të fala,
Nga xhaxhai Beqo Kushi, Kupja, Mania.
Edhe nga hallat e mia të mira,
Saforane dhe Fahro ke.
Trokas e trokas, por dera mbillur është.
Ma hapni derën e shtëpisë ku kam lindur.
Dua të hi e të shoh të parët e mi atje.
Shpirtrat e tyre zgjova këtu në Spatar,
Dhe nuja ime Zelo, m'u shfaq në fik hipur,
Dhe babai im Selman këtu është.
Këtu janë edhe Nesua, Ademi, Izeti,
Edhe Bashkimi, yt vëlla, këtu ka ardhur.
Trokas, trokas, trokas.
Po derën askush s'ma hap.
Spatari im vuv është,
Edhe shtëpia ime e vuosur është.
Emiljani lotët e mi sheh,
Emiljani lotët e mi fshin.
Më iku zëri. Më iku.
Atje në katin e dytë është mbyllur,
Dhe pastaj penxhereja e katit të dytë u hap.
Dhe m'u shfaq babai im Selman i përgjakur nga plagët.
Dhe zërin ulërimë të hallës Fahro dëgjova,
Po klante ajo për vëllanë e vrarë.
Dhe shaminë me gjak të plagëve të Selmanit,
Më hodhi si re të kuqe mbi kokë.
Kështu më foli xhaxhai im Jakup,
Me zërin që i dridhej,
Dhe lotët çurg i shkonin.
Dhe trokiste e trokiste në portën e mbyllur,
Të shtëpisë në Çamëri ku kishte lindur.

Tiranë, korrik 2024



Tri balada

BUZËMBRËMJA NË LIQEN

Nusja jonë, moj, nusja jonë! E syrit tim, bebëz-o!
Hajt! Më gëzo me një djalë, bajrak hedhur, dre
Në fushë. Sypishë, moj, qafëgastare. Hajt, më gëzo!
Ma nxirr, moj, këtë thellim! Copë e grimë e copë
E grimë. Oj e bardha, moj e zeza. Kam një krua,
Një oxhak, pyll të errët. Kam driza shumë, driza gjemba.
Edhe qengja. Kam at shale dhe mëshqerra.
Nusja jonë je, moj, nusja jonë. Dash bishtmendafshin
E shes për ty; e qes pushkë e qes allti; e shkel malin
Edhe fushën, bëj mrekuulli.

Krushqit u nisën të gëzuar, me lodra e këngë.
U kthyen me mëngjesin, me vesën që u kishte
Rënë mbi flokë e vetull. Ecnin buzëliqenit
Të heshtur; ecnin si mesdita parahistorike.
Sazexhinjtë mbanin veglat në krah, e ecnin
Kokulur, të ngrysur. Ishte karvan i çuditshëm.
Bajraktari në ballë, po flamurin s'ia merrte era.
Pas tij vinte një kalorës, mbi kalë të zi.
Të tjerët, dasmorë, këmbësorë të zymtë,
Shkonin prapa kalorësit. E prapa kalorësit
Shkonte nusja fytyrëshpaluar. Me velin e bardhë,
Si bora. Iku nga faqet e librit kalorësi dhe u doli
Krushqve në ballë, e u tha:
Nusen që po merrni, nëntë vjet e nëntë net, e prita Unë!
Kishte rënë pluhur shekujsh mbi teshën e tij.
Nga larg dukej si gogol orizoresh jugu.
Nusja jonë, e Bukura e Dheut, me velin e bardhë
Tani i shkonte prapa faqeshpaluar, ballëhënë.
Krushqit e ndoqën deri te pirgjet e dritës.
Dikur u dukën çati fshati me kashtë e me gjela.
Në kodër u ndal karvani, i çuditshëm.
- Po sazet përse nuk dëgjohen? E!
Vërtet dasmorët, krushq e fshatarë bashkë,
Dolën në kodër. Për kalorësin dikush tha:
Pas nëntë vjetësh e nëntë netësh, e gjet' fatin e vet!
Po ku mbeti kalorësi i zi? Mos e lëshoi toka,
Si pas tërmetit, si pas ëndrrës së ligë.
Ç'ishte ajo hije kalorësi, që krushqve u kishte pri?

MESNATA NË LIQEN

Nusja jonë, moj nusja jonë! E zemrës sime plagë e flakë.
Dilemë ditë, dilemë natë! Rridhmë përrua; ftohme krua.
Më vë në ballë akull, leckë, më vë në plagë lule nepërkë.
Më lidh prush, më zgjidh nur,
Ma bëfsh shtëpinë kështjellë me gurë.
Nusja jon, moj nusja jon: ditë e cektë, e bukur-o!
Djersë e ballit e tim biri! Nusja jonë, o!
Del si hëna pesëmbëdhjetë. Del si selvia me fletë.
Del me yjet, del me strallin, del me djalin del me mallin.
Barit natën binte vesa, yje binin mbi gjergjef.
Syprinë liqeni si kristali; yll drite në gjerdek.
Dasmorë e krushq i digjte hëna në fitil kënge.
Kur dikush thërret: Po nusja fatin a e gjet'?

AGU NË LIQEN

Nusja jonë, moj nusja jonë! Pus me ujë, mullar me bar.
Arë me farë, hambar me misër; perrri me hire;
Bebëz o, mall i djalit; djep i arit; pluhur yjesh; emblemë.
Gojëkuti. Gëzo mal e gëzo fushë. Ma nxirr këtë thellim!
Kam shkruar në gojë, dua vesë. Më gëzo me një djalë!
Limon në fytyrë, në shpirt kam valë.
Kur doli dhëndri prej gjerdeku, të gjithë plisat
E agut kishin zbardhëlluar mbi syprinën e liqenit.
Dasmorët po flinin mbi barin e tharë
Doli dhëndri prej gjerdeku, krisi pushka
-A bën t'ia nisim dasmës? - pyeti Plaku i shpatës,
-Apo t'ia ndalojmë lodrat? Si doli nusja?
Dhëndri u zgjua me këngën e këndesave të sabahut.
"Mos piqeni kafe të hidhëta!"-tha poeti. Një djalë
Si bajrak po hidhte valle midis logu. "Pritni, pritni", -
Tha poeti. "Tash fillojnë shirat e vjeshtës. Liqeni
Bën dashuri me retë e larta!"
Te kroi i fshatit do të rrijë një djalë me një vajzë,
Një plep i gjatë, një tufë e bardhë, një govatë druri.



Në 80-vjetorin e lindjes

RESUL SHABANI

Diçka po ndodh
në skenë

Një gurrë do të marrë udhë liqeni. Një arë do ta
Pjekë farën. "S'ka një vjet, do t'i thotë djali vajzës,
"Që u mbushën aq shumë vjet, kur im atë mori
Rrugën e kurbetit. S'ka një vjet, do t'i thotë djali vajzës,
Që u mbushën shumë vjet, që kur hija e një kalorësi
Erdhi dhe e dëgjoi vajin tim të foshnjës në djep.
Te kroi i fshatit i zuri vera dhe i shkroi në librin
E shenjtë të rrufeve. Një Afroditë dhe një Apollon.
Kurora lule nepërke kishin mbirë mbi kokë. Se poeti
Përsëri tha: "Lulja në kokën e gjarpit s'ka bukuri".
Zbritnin drejt vjeshtës, kah fshati e në sheshin e tij
Dasmorët po prisnin të merrnin rrugën e gjatë buzë
Liqenit, pas kalorësit që doli përsëri nga faqet e verdha
Të librit dhe me gojën e Plakut, dasmën e zbukuroi.

BABA

Në duart tua të çara, koha përsëri
Gjen shtigjet e saj të ndritshme.
Prej buzëqeshjes tënde e kemi ngritur
Një ujëvarë hidrocentrali
Lart në bjeshkë, fyelli buzëqesh
Me zërimin e tij jetik, e
Ai që e stolisi heshtjen tënde
Me hieroglifë pikëllimi, pushon
Nën hijen e rëndë të manit
Në oborr, në çatitë e mbuluara me vesë.
A është e rëndë dashuria jote,
Sa malli për livadhin e djegur?,
Mëxhok i butë dhe mëxhok i egër
Që përfaqon vetëm kur s'je.
Në duart tua të çara, koha përsëri
Gjen shtigjet e saj të ndritshme.

Në heshtjen tënde të ndezur,
Sillet një flamur, fluromë e djegur.
Është mendimi yt që la blozën
Në të kaluarën dhe i bën dritë asaj që vjen
Të kam parë shekujve ulur
Në një trung lisi të rrëzuar si historia.
Prej tymit të cigares tënde,
Krijohet përkufizimi i kotë i pikëllimit
Për vëllain tënd që e gjete në zabel
Të fjetur nën kurorën e luleve.
Ata që s'të kanë parë duke kositur tërtilin,
S'dinë asgjë për yjet;
Ata që s'të kanë parë duke ndarë vadën,
S'dinë asgjë për detet.
Në heshtjen tënde të ndezur,
Sillet një flamur, fluromë e djegur

Ata që s'kanë ecur natën buzë liqenit,
S'e dinë sa i thellë je.
Mes prushit tënd të mbuluar me hi vatre
Është pjekur buka e grunjtë.
Mes duarve tua ka marrë frymë
Krejt blerimi i harruar në bjeshkë.

Ata që barrën tënde e kanë bartur
Në kuriz, s'kanë qenë në jetë,
Prandaj dukesh si një llambë e verdhë vajguri
Territ të shekullit kur i buzëqesh.
Ata që s'kanë ecur natën buzë liqenit,
S'e dinë sa i thellë je.

Tani rri buzë vatre, si e vetmja
Magji e krijuar prej përfytyrimit,
Por, as je magji, as je përfytyrim-
Ti je kala e krijuar në kohë
Që mbron stuhitë për dashurinë
Që mban kokën lart për të gjithë.
Ata që janë e s'janë më në mesin tonë,
Mbetën e shkuan me amanetin tënd.
Fjala jote është vendlindja ime,
Ti je liqeni i saj më i thellë.
Tani rri buzë vatre, si e vetmja
Magji e krijuar prej përfytyrimit.

MOTRA

Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore në liqen,
Ma bëj këngë bilbili, vajin tim
Të fëmijërisë. Njëpër ograja e zabele,
Ditët e mia rinore, ju përshëndes.
A është kjo degë jargavani
Në duart e mia lule akacie
Dhe erë ftoi? Pranverë dhe vjeshtë;
Pleqëri dhe rini,
Djalëri dhe fëmijëri - jeta me valët po rrjedh
Dhe me vajin e malit kur e rrëmbyen
Puhizën e lehtë me flatra ëndrre.
Po kthehem! A do të të gjej?
Lojërat e fëmijërisë, të pakuptimta vallë, janë?
Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore në liqen.

Të kam fshehur në guximim tim
Të dalë përballë përrallave natën,
Kurse ty të kam vënë të flesh
Në shilarësin e florinjët të përfytyrimit.
Ata që kanë guxuar të flasin
Për yllin tënd në ballë janë gladiatorë
E gjarpërinj dhe shtozovalle.
Në pyll ti më ke bërë të jem trim,
Kurse tani po dridhem.
Në ballin tënd po bie si yll i shuar
E po kthehem askund.
U dogj krejt mali ynë dhe liqeni.
Midis gishtave kjo lule mëkatore
Po venitet me drithërimë.
Të kam fshehur në guximim tim
Të dalë përballë përrallave natën.

Edhe pranverë, edhe liqen të kaltër
Ka në sytë e tu, e dashura motër
E kam parë yllin polar
Duke të buzëqeshur, gjersa ti flije e qetë
Në shtratin tënd prej guri
E kam shtruar krejt stinën time të bardhë.
Tani po kthehem në dherat e largëta
Ku do të të gjej në një fjalë
Dhembjen tënde, e dashura motër,
Do ta ndajmë së bashku si një kafshatë.
Edhe pranverë, edhe liqen të kaltër
Ka në sytë e tu, e dashura motër.

Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore në liqen,
Në daç të dish se sa i pushuar mbeti
Prushi i mallit tonë në zemër;
Në daç të dish se sa i xhevahirtë
Është ylli polar në ballin tënd
Se unë mundem vetëm me dy fjalë
T'i krijoj të gjitha melhemet e ilaçet.
Midis meje e teje, një mur të lartë
Sa heshtja dhe largësia mund ta shemb.
Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore në liqen.

KUMRIA

Do ta kisha zgjedhur një ëndërr
Për natën tënde e ta ëndërrosh.
Në vajin tënd do ta kisha varur
Një fije kohe të blertë si kopshti im.
Po dite ta kërkosh vëllain tërë jetën,
Dije se dite të dashurosh.
Hijen e kujtimit nën pemë,
Hijen e dashurisë nën përrua, moj e hollë,

ti po ikje
 prap me pikellimin tim pa fund
 prap me vetmine time unë
 si është kështu kjo jete
 gjithcka shkon në hic
 më erdhi të qaja sytë në lot
 më erdhi të therrisja fort në emer
 ah porosia jote më mbaj sekret edhe sikur
 të vdesësh
 ooooo.....
 eja prap para se të kem vdekur

duket qartë
 në ditet tuaja të nesërme unë nuk do jem

si dimrit një bredh mbështjellë me dëbore
 do jem.

zogu që vizatova unë
 i bëri glasën antenës së tv
 dhe fluturoi
 dhe u ngrit lart në qiellin e mbetur bosh
 më bosh se unë

kur më merr ti përdore unë vij me ty
 jam rritur rrugëve

unë shoh shumë endrra
 ti mban të fshehur lulen e vizatuar për mua

mëllenjë e zezë
 pulson gjaku jot i kuq
 rri e rri dhe mendoj si ndjehet zemra jote e
 vogël natën
 nën pyllin e zi

unë kam parë gjak njëri në asfalt
 e grinë me plumba para syve të mi
 në çdo kohë
 në mengjes
 në mbrëmje
 në mesdite
 për çdo nate
 dhe për çdo ditë
 gjej përpara portes time të shtëpisë
 një të vdekur
 të vrarë
 një femije të pafajshëm
 që ende nxjerr nga goja gjak të ngrohtë
 nga që s'kam çfarë të bëj
 kafshoj duart e mia
 ulërij
 bërtas
 u çmenda
 nuk jam më njëri

ma tha vetë me gojën e saj :
 vetëm dashuria të bën të lirë
 tani jam skllavi i saj

mendova se barbarët ikën
 u zhduken përgjithmonë
 sikur të mos i binte rruga kujt matanë
 portes time

vjen nata dhe ti sheh yllin që rron mes yjesh
 gjithmonë në kerkim të fatit tënd

të tregova për trishtimet e mia
 të degjova ty për trishtimet tuaja
 dhe të desha shumë e më shumë

yjet lëvizin nepër qiej
 unë prek me duart e mia natën
 mëllenjë e zezë që leviz përfund shkurresh
 gjithë frikë



XHELAL TOSKU

tani na ndan vetem nje vije e holle loti

askush nuk të përkëdhel ty

dhe yjet lëvizin nëpër qiej

o burra të gjithë njërezimit
 o të diturit e gjithë njërezimit
 o të mençurit e gjithë njërezimit
 më thoni ndonjë gje si të sillem me djallin

përbri rerës dhe detit
 si fener i zbehtë që shuhet në agim
 të kam prituri të vish

me gjasë mbas pak unë do iki
 me gjasë edhe pak dhe ju pas meje atje do
 vini
 me gjase unë nuk do kem shpetim

jeta e një gjetheje i takon së shkuarës
 ti më rri në mendje si një pemë e zhveshur

fituam lirinë në dheun tonë
 u bëmë skllever në dhera të huaja

nga të gjitha përrallat që kam degjuar me
 shume janë përrallat e lirise

edhe fjalët me shkrim i merrka era
 edhe i vetëm
 stuhia duhet prituri

ty të pruni Zoti krejt lakuriq
 të mori nëna në krahë të puthi dhe të
 mbuloi
 ti u rrite
 erdhi burri (piktori skulptori) burri
 gjithsesi
 dhe nuk bente dot pa të zhveshur lakuriq
 ti u bëre grua u bëre nënë
 nëna pa të cilen unë dhe kjo botë
 do ishim krejt lakuriq

në rrugën e pafund unë shoh fundin tim

përvec Zotit
 kush deshi tjetër
 që unë të jem njëri

ma tha vetë me gojën e saj : vetëm dashuria
 të bën të lirë

tani jam skllavi i saj

nuk kam për ta harruar të qeshurën tënde
 dhe heshtjen si krizantime e gjelbër
 që të pushtonte pastaj
 kurrë nuk ia gjeta dot kuptimin

jetojme në një bote të lire
 shijojme lirine e botes
 gjithmone në udhetim
 gjithmone në levizje
 ne toke në ajer në dete
 me vetura autobuze trenat anije avione
 sipërfaqja që shohim me shpesh
 është shpina e tjetrit
 e mikut
 e shokut
 e vellaits
 e motres
 e gjithë të dashurve tanë
 unë ja përqark e rri në vend

nuk kam zë

e kam në mendje natën
 e kam në mendje qiellin

u keput dhe ra ylli
 qielli plot pikellime

unë nuk flas
 në thellësi unë hesht

nata bëhet oqean
 kush di si është të qëndrosh në breg
 jam pa ze

unë kam ndezur zjarr
 po zjarrin drurët nuk e duan
 dhe me të drejtë
 zjarri të djeg
 zjarri të ben shkumb

dhe era për drejt
 zjarrin e madh e rrit
 te voglin zjarr
 era e fik

kam ndezur zjarr zjarr të madh

thuaje një fjalë
 bertit
 ulurij
 po ti nuk je dru

pastaj le të digjem vetëm unë
 vetem unë le të behem hi

prej zjarrit tim

verë e nxehtë dhe e thatë
 dola në pyll mblodha manaferra

si nuk i paskam harruar gishtërinjtë e tu të
 vegjel

o pafajsi e kulluar

dola në pyll për manaferra

si je ç'ben
 kushedi sa larg ke shkuar
 s'di me sjell ndonjë here ner mend
 apo me ke harruar

o pafajsi e kulluar

verë e nxehtë dhe e thatë
 dola në pyll për manaferra

vetëm ti dhe pylli
 vetëm ti pylli dhe unë
 dhe çfarë na duhet tjetër
 për të mbruritur gjer tek fillimet e njëzimit

tani na ndan vetëm një vije e holle uji
 loti

nuk kam për ta harruar të qeshuren tënde
 dhe heshtjen si krizantime e gjelber
 që të pushtonte pastaj

kurrë nuk ia gjeta dot kuptimin

ti je si një gjethe
 pret të përkëdhele era

unë nuk di kush jam

n' çdo rrugë të qytetit ka vija të bardha
 dhe unë jam rrit në katund
 gjithandej në qytet do të dalë përpara një
 polic
 dhe unë jam rrit në katund
 në çdo cep në qytet kanë vendosur kamera
 dhe unë jam rrit në katund

të dal apo mos të dal në qytet
 unë jam rrit në katund

prifti kaloi në rrugë
 hënë e ftohte atje lart
 për pak do bien kambanat e kishës
 askush nuk ma di merakun
 askush nuk do lutet për mua këtë natë

Flora Brovinës

të voglat gjethe si flatra
 që u rriten lart në maja
 i flak era nepër ujra
 i hedh era nepër baltra

kjo është jeta
 ky është dimri

edhe unë jam bimë
 edhe unë jam zë

e morën gurin e shkëputen nga mali
 me varre me qysqi me çekiçe me dalta e
 gdhenden dhe bënë heroin e tyre
 here pas here shkojnë të marret dhe e
 pshurrin

unë nuk kam qene ndonjëherë hero



Karikaturë nga Arben Mexsi

As kujtesa, as...

Asgjë pas...
Ngrohtë, ftohtë, squllur,
Fjalët me lule... vetëm çast

Harresa... e ndrojtur,
mrrudhur.

Asgjë pas,... as Kujtesa, as...?!

Vlim

Kokëkrisja kërkon atdheun tim, tëndin
Lavditë e tij ndizen dhe digjen
nga të gjallët, të çmendurit.

Vrullti... kujt i bie hirnosja e re mbi krye
nga përdëllim' i thellë e më i flashkët?
Kokëkrisja vrapon mpakur... soditje !

Atdheu po mbytet... A ka shpëtimtarë?...

Pa tepri

Me tepri ftillohen shpirtrat,
Me tepri sos vraga vragë
Në çdo letër shkruan
Pritja
herë me syza
herë me çark.

Çdo të shkruaj shpirti sot?
Gjithçka tha e s'po mund?
Me qortime e me Zot
rrojme këtu
a tjetërkund?

Far loti

Sikur të binin sot
sirenat e portit
jo për alarm

varkat do të kuturisinin
nga cekëtinat e të ftohtit,
Fari e loti ato i mban gjallë.

Si mund të ngjallen cimat
të kërcejnë sot peshqit
ndjerë e të zhgënjyer
teksa mendja vërvit
topitjet e të pazotit,
Kumbona e erës
gjithëkund
përplas
kryet...

Ah, sikur të binin sirenat e portit...

Taksbrenjë

Taksa për çerdhet e zogjve nën strehë
për byth-zbatharakët do vilen taksa,
taksa për trastën që rr'mon pleh
nga plehrat krela të k'saj
Shëtitoreje farsash.

Taksa për farsat, gurët e amfiteatrit
shulluar qyshkur pa prerë
për vete asnjë biletë,

taksa për bilbilat që trallisnin beharin,
taksa për librat që pa pyet kënd
mardhin nën hundën e squllët
Biblio - Shtet.

Taksën e vetes e paguaj me brenjë.

Skulpturë antike

Kjo skulpturë bore tretet
po e lamë pasdore, andaj
me gishtat tanë të ngrohtë
t'ia ledhatojmë fytirën prore
gjersa ajo të mbri në aeroport.

Për atje është nisur...e mori Era
mbi supet e saj si një përshtirje -

Taksën e vetes e paguaj me brenjë

poezi

Nga Ruzhdi Gole



Kudo le t'ulet kjo skulpturë antike
edhe pranë meje me ftohmen ndritur
veçse jo papritur fletëzave prej helike...

Çeljetë

Çeljetë puqemi edhe më çiltër
prej bishës gllabërohemi
gllabërojmë gjumjen
gjakftohtë, soditës.

Zgjohemi... mëngjez(s)orë mbi gjumje
të mos gllabërohemi nga vetja
prej shkume...

Valë

Zonjë,
t'ka lezet gjithçka
për bel e për bela...

... valëzoi veç tue t'pa ...

Gisht ere

Rrallë, pa faj dëgjohemi midis
mbrëmje te mbrëmjes
kthjell-errët

Me buzë pëshpërisim rrezet në risk
nājri shkruajmë me gishtin e erës.

Ne, prindërit borëtojmë dhe mes vere
kur dita me kthetër na shqyen
buzë-tuturitjen si lajm.

Fëmijët janë dashuri e të tjerëve
afërlarg nesh... ende pa faj...

Triumfe lajlelule

Vjedhja duart nuk i mban në xhep,
me këmbët biologjike udhëton
shpesh edhe me auto-burg,

shpik çka nuk shpiket, ngahera
gëzon kënaqshëm shëndet,
atdheun vreshtë rrëkëllen
në klubin kuvendar
bashibuzuk.

Vjedhja asnjëherë nuk është e dalë mode
madje g'zon respekt për veshjet, veglat
si maska, kokorja, lajlelule këmisha,
droga e ndershme ardhur këtu
për kurbet, fisheku akcent,
rrahja dhe thika.

Në mes të hajdutëve plot të mençur
neve na vjedhin jo nga xhepat
na vjedhin nga mendja
me farë e më gungë,
toç e të tredhur
gjëndra

biologjikë
të pushtetit
anadollako - bashibuzuk..

Kyç, vraja

Qelia tund çelësa lart poshtë
mbyll e hap zgavra qelish,
burgu jeton çdo moshë
pa moshën vis foshnjë,
burgu mendon veç
hopthi arratish.

Befas brenda meje tundet
një çelës por unë nuk ia
mbath sot me të katra...
shumë burgosur jemi
edhe jashta
hiç flatra
vatra,

Ne në horizontin kyç
vraja të mbrapshta
me thonjtë në fyt.

3 Maj

Shiu e Dielli këmbajnë të qeshura
se qesh edhe shiu qan pak dielli
pa u duk, bluza e shiut ndrit
plot rrezë, flokët pantollat
e diellit kullojnë qull.

Shiu i afrohet diellit aq sa mundet,
dielli i afrohet shiut aq sa desh,
era, mes tyre, mban në dorë
një tufë lulesh, pret dikë
prej tyre, të dy njëher'sh...

Shiu dhe dielli lotrrezë qeshin
lodrojnë mes tyre erën
pastaj të tre gjithçka
e falin për të tjerët.

Solfezh vere

Shpotitje të shpeshta,
mëni të mrrudhura
ballkonet valavisin
larjet e freskëta
ndonjë turpësi
havaje nājri
t'gurgullta.

Rruga fjaloset më shpesht
me qeshjet vajzat e veta
nga kodrat përreth
zbrësni përdore
solfezh verore
kopshtet,
vreshtat.

Ja, deti... Golemi prushnaje -
Shpotitje mes veti
këtu ndalohen
urdhërat
mënitë
Fajet
falën.

Çast i vranët

Karriket me spaleta
spaletat me grada
gradat me pritjet
pritjet vagull
t'athëta.

Spaletat katër këmbë
katër këmbë pushteti,
Pushteti me paruke
shkelmon
t'vegjëlitet.

Mbrëmje artistike. Kupola afsh.
Spaletat vranësojnë pritjet,
Poetët asnjë çast.
Kub dhome

E vranët Fjala jashta, përjashta
vetullat i kërcejnë plasa-plasa.

Xhami këtu luan rrëshkekë fantazish
plot sy e gishta, sy gishta stolish.

Nënkresa lule ujitet gazmendesh,
veriga e seksit shkund frutet
mburret trembja, trembet.

E vranët fjala, vetullash plasa,
këtu gënjejme, gënjehemi jashta.

Prajti bora

S'prajti bora, s'prajtën përpjekjet -
Kosa ende nuk i njeh të korrat,
rruga këqyr një bisht komete.

Mbahet rruga tej kometash
plot përfaqje fisnikërisht
dimri kothere eshtrash
l'pin, çukit gishtrinjtë.

Dimri ngopur shqotë e zhguna
është nuk është mendjethati
prajti bora thellë urnash
rruga drithmë lëkurë
gjarpëri...

prajti bora, vorfnia s'prajti...

Vetmi... tingujsh

Qeti shtëpie mbasdite
e shtuna ulur në karrike.

Qashtër sytë, rrezja në gjoks -
Shoh qiellin plot valavitje
romantik, më shumë
se çdo harlisje,
shurdh, bosh.

Plot buzagaz shtëpie
gjithçka mbasdite,
Vetmia e çiltër
ujitet prej
tingujve.

Rimë tjetër

Plot gjemba, plot vetëtima koka...
brenja me rima, rima me gropa.

Veç zogjve nëpër ajer
nga koka me vrima
fluturojnë
gropa,
rima...

Kumbona, e zvargur, bosh -
Gjemb plas tëmthnin,
jehona josh...

Fëmijë hëne (naive)

Hënë:
Ne fëmijve na qëllojnë
me plumba të vegjël
Përse na vrasin?

O ëngjëlli im:
Lufta vret
At e Mëmë
sidomos
fëmijët
pasardhësit...

Hënë,
Mos zbrit' në Tokë
mund të të vrasin...

PASHKO R. CAMAJ

Porosia e kullës

Parathënie nga Besnik Mustafaj

Onufri **Kujtime**

